

CIKLI I TË MËSUARIT NGA LËNDA E GJEOGRAFISË



DORACAK PËR TRAJNIMIN E ARSIMTARËVE TË GJEOGRAFISË NË ARSIMIN FILLOR

Komponenta për përmirësimin (përparimin) e arsimit nga matematika dhe grupi i lëndëve të shkencave natyrore, realizohet në mbështetje teknike të Universitetit në Indiana

**CIKLI I TË MËSUARIT
NGA LËNDA E GJEOGRAFISË**

**DORACAK
PËR TRAJNIMIN
E ARSIMTARËVE TË GJEOGRAFISË
NË ARSIMIN FILLOR**

**Materialet për këtë trajnim
janë të përgatitura me ndihmë teknike
dhe profesionale nga Universiteti në Indiana**

Ky doracak është finansuar nga populli amerikan nëpërmjet të **Agjencionit të SHBA për zhvillim ndërkombëtar – USAID Maqedonia**, në suaza të **Projektit për Arsim Fillor** të cilën e realizon **Akademia për zhvillimin e arsimit (AED)** në bashkëpunim me **Qendrën Maqedonase për Arsimim Qytetar (MCGO)** dhe **Universitetin në Indiana**.

Materialin e përgatiti:
Nikola Dimitrov

Bashkëpunëtor:
Ivica Gievski

Redaksia profesionale:
Anica Aleksova
Terry Masson

Përkthimi:
Gani Ameti

Përgatitja grafike:
Biljana Mihajlovska

Materiali është bazuar në doracakun përgatitur nga Dr Charles Barman, Classroom Materials for Teaching - Learning Science, është përdor për trajnim të trajnuesve në Projektin për shkollat fillore, korrik 2007

Qëndrimet e autorëve të thëna në këtë doracak nuk i shprehin qëndrimet e Agjencionit të SHBA për zhvillim ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

HYRJJE

Nevojat për të analizuar, reviduar dhe modernizuar gjendjen në arsim, në kuadër të sistemit tonë arsimor, kohëve të fundit janë në lidhje të ngushtë me tendencat që të përparohet arsimi fillor te ne, adekuat me marëdhëniet shoqërore dinamike, marëdhëniet sociale dhe ekonomike. Poashtu, në kohën e revolucionit komunikues, është e domodoshme TIK të jetë katalizator në transformimin e arsimit, por jo edhe çelës për ndryshimet në arsim. Për këto arsye, është parashikuar se në ndryshimet e sistemit arsimor te ne (sjellja dhe aplikimi i rregullativës së re, koncepti i ri për arsimin fillor, përpunimi i planeve të reja arsimore dhe programe të reja / të inovuara, patjetër t'u paraprijnë përgatitjet profesionale dhe organizative të orientuara kah pjesët e veçanta të sistemit (mes të cilave janë edhe ato metodiko-didaktike), me të cilat nëpër shkollat do të krijohen parakushtet për sjellje të suksesshme të ndryshimeve madhore në pjesën më të rëndësishme të sistemit - mësimin. Në drejtim të sigurimit të ndihmës në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë, në vitin 2006, Agjencioni për zhvillim ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID) për Maqedoni filloi një projekt të ri pesëvjeçar, të quajtur si projekti për zhvillimin e arsimit fillor (PEP). Në PEP do të përfshihen të gjitha shkollat fillore në Maqedoni, kurse qëllimet e projektit janë: përmirësimi i cilësisë së arsimit; zmadhimi i aftësive punuese të rinjtë; zmadhimi i qasjes në kompjutor dhe integrimi i shfrytëzimit të teknologjive informativo kompjutorike në të gjitha lëndët mësimore; përparimi i mësimin nga matematika dhe lëndët natyrore dhe përmirësimi i vlerësimit në nivel të shkollës me qëllim të stimulimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimin.

Njëra prej katër komponentave të PEP-it është komponenta: Përparimi i mësimin në matematikë dhe grupin natyror të lëndëve, në kuadër të së cilës do të **ndërmirren aktivitete** që të aftësohen nxënësit për vështrim kritik që do t'u ndihmojë të arrijnë suksese në ekonominë globale të bazuar në dituri, që të përkrahet zhvillimi profesional i arsimtarëve dhe të krijohen burime për të mësuar përmes projekteve Gjatë 5 viteve të ardhshme PEP ndërmerr aktivitete në këto lëmi vijuese:

□ **Përmirësimi i programeve arsimore**

PEP do të sigurojë ndihmë profesionale, hulumtime, modele dhe përkrahje për përmirësimin e programeve arsimore nga matematika, fizika kimia, biologjia dhe gjeografia, të cilat do të udhëzojnë kah ajo që nxënësit të përfitojnë shkathësi adekuate nga arsimimi të nevojshme për të qenë të suksesshëm.

□ **Përgatitja e doracakëve dhe materialeve digjitale dhe të shtypura**

Aktiviteti i rëndësishëm në të cilin do të punojë PEP komponenta për përmirësimin e mësimin nga matematika dhe shkencat natyrore është rritja e kompetencave të arsimtarëve për kreacion të burimeve përkatëse për mësim. Së bashku me partnerët, antarët e grupeve punuese dhe TIK komponentës do të identifikohen burime të ofrueshme për matematikë dhe grupin e lëndëve natyrore, përmbajtje që kanë qasje për gjuhët arsimore në Maqedoni dhe burime pa pagesë nga interneti të cilat mund të adaptohen dhe përkthehen. PEP do të ndihmojë në zhvillimin e përmbajtjeve digjitale të cilat do të jenë të ofrueshme pa pagesë të gjitha shkollave.

□ **Trajnimi i kuadrit arsimor**

PEP do të aftësojë trajnues (profesorë të fakulteteve arsimore, Kshilltarë nga Byroja për zhvillimin e arsimit dhe arsimtarë) dhe të gjithë arsimtarët nga lëndët përkatëse, për planifikimin, përgatitjen dhe aplikimin e metodave aktive të mësimdhënies dhe të të mësuarit, sikurse të mësuarit përmes zgjidhjes së problemeve, hulumtimit dhe të mësuarit përmes punës nëpër projekte.

- **Përkrahje të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të kuadrit arsimor**
Përmes kombinimit të modeleve kaskade të trajnimit dhe trajnime në nivel të shkollës. PEP do t'u ndihmojë aktiveve të arsimtarëve nga matematika dhe shkencat natyrore përmes përgatitjes së propozim programeve dhe aktiviteteve të cilat do ta përkrahin zhvillimin profesional të arsimtarëve në nivel të shkollës.
- **Vlerësim formues më cilësor**
Së bashku me PEP komponentën për përparimin e mësimit formues, do të trajnohen arsimtarë nga matematika, fizika, kimia, biologjia, gjeografia, për përgatitjen dhe shfrytëzimin e detyrave të cilat masin shkathtësi dhe aftësi për zgjidhjen e situatave problematike dhe hulumtime.

Në kuadër të PEP, përveç trajnimeve – arsimtarëve do t'u sigurohet përkrahje në procesin e aplikimit të njohurive të posafituara dhe shkathtësive gjatë punës me nxënësit. Këtë përkrahje arsimtarët do ta marrin nga inspektorët e Inspektoratit Shtetëror të arsimit, këshilltarët nga BZHA, trajnuesit, mentorët nga partnerët për trajnim, të cilët do t'u ndihmojnë përmes përcjelljes së rregullt dhe evaluimit të arsimit dhe të të mësuarit. PEP poashtu do të përcjellë dhe informojë për suksesshmërinë e bartjes së praktikës së re nëpër shkolla. Ky është trajnimi i parë për arsimtarët e gjeografisë nga shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë

Trajnimi është orientuar nga përpunimi dhe futja e Cikllit të të mësuarit në katër faza¹, si modele didaktike të cilat sigurojnë qasje të orientuar kah nxënësi nëpërmjet zbulimit, mësimit dhe zhvillimit të shprehjeve dhe përmbajtjeve nga gjeografija, nëpërmjet hulumtimeve dhe eksperimentimeve².

Ky trajnim ka për qëllim:

- Të ju informoj për USAID/ Proektin për arsim fillorë në të cilin është kyçur shkolla Juaj
- Të ju mundësoj sendërtimin e diturisë dhe aftësitë të cilat i dispononi për realizimin sa më të suksesshëm të përmbajtjeve nga gjeografia
- Të ju ofron modele të mësimit nëpërmjet zgjidhjes së problemeve dhe hulumtimeve
- Të njoftoheni me Ciklin e të mësuarit si model i mësimdhënies dhe të mësuarit nga gjeografia
- Të fitoni aftësi dhe dituri për zbatim, planifikim dhe realizim të orës mësimore sipas Ciklit të mësimit

Organizimi dhe mënyra e punës së trajnimit

Pjesa më e madhe e këti trajnimi paraqet, kyqjen aktive të Juajen dhe puna në palë dhe grupore, ashtu si do të duheshte të ishte organizimi i punës, me nxënësit në orën e gjeografisë. Aktivitetet në puntoritë më shpesh do të mbahen në disa faza: e para - të menduarit e juaj dhe puna individuale, pastaj - puna në çifte apo në grupe, dhe pastaj prezentimi i fryteve nga puna e grupit tuaj. Puntoritë do të përfshijnë edhe hulumtime në mvarësi prej përmbajtjes mësimore nga gjeografia.

¹ Pjesë nga ky material janë drejtpërsëdrejti të marura nga Classroom materials for teaching and learning science, Charles R. Barman, Indiana University School of Education, Indianapolis, IN Dr Charles Barman është konsulltant nga Universiteti në Indijana për USAID/ prjektin për mësim fillor

² Më shumë për formimin dhe zhvillimin e nocioneve si dhe zhvillimet e periudhave të nxënësit lexoni në materialin për trajnim të trajnuesve - Përmisimin e të mësuarit nga grupa e lëndëve natyrore.

Tema 1

MËSIMI CILËSOR

MËSIMI CILËSOR

Njëra nga parashikimet për realizimin cilësor të orës mësimore është përgaditja e suksesshme, gjegjësisht, si duhet profesionalisht dhe në mënyrë cilësore, arsimtari ta planifikojë dhe realizojë orën. Poashtu, parakusht i rëndësishëm për orën mësimore të suksesshme janë karakteristikat e pjesëmarrësve në proceset: arsimtari dhe nxënësi, por nuk duhet anashkaluar dhe ndikimin e kushteve në të cilat zhvillohet mësimi.

QASJE TË REJA NË TË MËSUARIT NGA GJEOGRAFIA

- **Proçesi mësimor të jetë i bazuar në integrimin e përmbajtjeve mësimore, lidhja vertikale dhe horizontale e tyre, si dhe lidhja në tërësi më të gjëra dhe lëmi të arsimit.**
- Integrimi dhe lidhja në mes përmbajtjeve mësimore mbështeten në **integrimin e tërësive dhe rezultateve të pritura/efekteve**. Nga tërësit tematike të ndryshme në kuader të një lënde mësimore, si dhe nga lëndët dhe sferat e ndryshme mësimore.
- Gjatë integritit të lëndëve mësimore patjetër duhet **ruajtur bazën shkencor dhe profesionale të përmbajtjeve, karakteristikat e zhvillimit të nxënësve në periudhat e caktuara të zhvillimit, poashtu metodat dhe format e arsimit dhe të mësuarit.**
- Karakteristikat zhvillimore të nxënësve e modelojnë, **mësimin interaktiv dhe metodat për mësim aktiv**, e cila nënkupton përmbajtjen mësimore dhe metodat në edukim dhe mësim të mbështeten në **zhvillimin e aftësive dhe strukturën e të menduarit tek nxënësit**, që të mundësohet nxitja dhe **zhvillimi i aftësive intelektuale të tyre**.
- **Operacionet e të menduarit tek nxënësit** të cilët e mësojmë grupin e lëndëve natyrore janë: **zhvillojnë** nëpërmjet **zgjidhjeve të problemeve** (zhvillimin e aftësive për konzervim për nxitje dhe përvetësim konkret dhe intuitiv dhe të kuptuarit të ideve themelore në sferën e natyrës dhe të kuptuarit e natyrës si tërësi).
- **Metodat mësimore i përshtaten qëllimit - nxënësit të përvetësojnë sistemin e diturive dhe konceptet** e tërësishme, me qëllim të nxitjes të zhvillimit intelektual të nxënësve.
- Gjatë realizimit të programeve mësimore nga grupi i lëndëve natyrore, duhet të japin rëndësi **për shfrytëzimin optimal të informatave teknologjike** gjatë procesit të mësimdhënies dhe të mësuarit.

QËLLIMET E TEMËS

- Të kemi parasysh karakteristikat e mësimit cilësor.
- Të shiqohet mundësia kontinutive për përmirësimin e arsimit.
- Të identifikohen elementet të orës së suksesshme.
- Të praktikohet përgaditja e mirë, e cila është parakusht për orë të suksesshme - cilësore.

KARAKTERISTIKAT E MËSIMIT CILËSOR

Nocioni mësim “cilësor” gjithnji duhet në mënyrë relative të interpretohet, për arsye se në thelb në kuptim të vërtet, nuk ka mësim cilësor e cili nuk mund të përmirësohet. Për të siguruar shkallë më të lartë të cilësisë në procesin e mësimin dhe mësimdhënies duhet të plotësohen disa kërkesa:

- Mësimi të shihet si sistem i tërësishëm
- Ndryshimi i stilit të punës së arsimtarëve
- Ndryshimi cilësor nëpërmjet kujdesit të vazhdueshëm - përsosje të palnifikimit, organizimin dhe vlersimin permanent të të arriturave
- Zbatimi i formave të ndryshme, metoda, veprime, strategji dhe realizim teknik i procesit mësimor
- Shfrytëzimi i resurseve teknike më moderne
- Pranimi i nevojës për ndryshime dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të kuadrit mësimdhënës
- Arsimtari të jetë udhëheqës i ndryshimeve
- Përcjelljen e përhershme të zhvillimit të shkencave dhe njohurive të reja shkencore- teknologjike
- Zbatimi i modeleve mësimore: aktive, problematike, zhvillimore, hulumtuse e orientuar kah nxënësi dhe thurrur sipas masës së nxënësit
- Modernizimin e arsimit nga ai egzistues kah i prituri, nga ajo që kemi dhe dimë kah ajo që dëshirojmë
- Roli aktiv, kreativ dhe qëndror i nxënësve
- Shkollat janë ente në të cilat më së paku ligjërohet, kurse më së shumti mësohet
- Më e rëndësishme është se çfarë janë të ariturat e nxënësve, e jo numri i orëve të mbajtura apo ligjeratave të mbajtura të arsimtarit
- Ndryshimi i renditjes së orendive, paisjeve dhe hapsirës së punës, me qëllim që sa më shpejtë dhe në mënyrë sa më efikase të arrihen qëllimet e parashtruara
- Mësimi bazuar në motivimin, zhvillimin dhe respektim i personalitetit të nxënësit
- Nxënësi bëhet subjekt i mësimin, gjithnjë e më tepër vetë zgjedh çka dhe si do të mësojë, diskuton me nxënësit tjerë dhe me arsimtarin, gjithnjë e më tepër vjen deri tek diturit e reja, zgjidh probleme, se sa që pranonë dituri të gatshme.
- Arsimtari fiton rolin e mësimdhënësit, mentorit, me rol më përmbajtësor, më të komplikuar, më subtil, më të rëndësishëm dhe rol më të përgjegjshëm.

KARAKTERISTIKAT PËR ORË MËSIMORE TË SUKSESSHME

1. PARAQITJA E QËLLIMEVE TË ORËS

(Tregoj nxënësit se me çka do ta aftësosh dhe mësosh, veçoi qëllimet konkrete të orës, njohurit dhe aftësitë të cilat do ti fitontin nxënësit, identifikimi i nocioneve të cilat duhet t'i përvetësojnë.)

2. ORGANIZIMI I ORËS

Organizo përmbajtjen të cilën do ta zhvillosh në orë sipas renditjes logjike.

(Renditja e përmbajtjes për zhvillimin e nocioneve gjatë fazave nga ora, renditja e përvojës e bazuar nga njohuritë e paraprakea dhe përvoja, renditja sipas interesit, definimi i nevojave të mjeteve mësimore, teknikat, materiali, lidhja ndërmjet lëndëve, mjete dhe veprime për vlersim dhe të ngjajshme.)

3. PËRDORIMI I METODAVE INTERAKTIVE

Aktivizoni nxënësit gjatë orës.

(Mos mendoni se duhet gjithçka t'ju tregoni nxënësve. Përdorni metoda interaktive në punë, punoni në grupe, paramendojeni aktivitetin e nxënësve gjat orës, shfrytëzoheni teknologjinë informatike. Prezantoni material pastaj mendoni mënyrë që nxënësve tju mundësoni ta thonë ate të cilën duhet ta dinë / mësojnë.)

4. SHFRYTËZIM TË INFORMATAVE TË VËRTETUARA DHE PRAKTIKE

Vetëdije, konkretshmëri dhe praktikueshmëri të informatave të cilat dëshiron t'i prezentosh.

(Informacionin duhet mirë ta dish, kuptosh, shfrytëzosh, krahasosh dhe zbatosh. Informacioni duhet të jetë konkret dhe praktik.)

5. KËMBIMI I INFORMATAVE PËR NJOHURITË E NXËNËSVE

Të dish kur të ligjërosh, e kur të mësosh / mësimi është përcës i këmbimit /

(Tregonju nxënësve se "Di diçka që dua edhe ju ta dini, ti, din diçka që unë kisha dashtë ta di, te ne(mendohet në interakcin arsimtarë - nxënës)ka diçka të re që duhet ta ndajmë".)

6. ZBATIMI I NJOHURIVE TË NXËNËSVE

Ndihmoju nxënësve ta zbatojnë konceptin e njohurive mbi situatën e tyre.

(Së pari: Identifikoji konceptet e rëndësishme- idetë e përmbajtjes mësimore; E dyta: Sipas mendimit tuaj pse janë të rëndësishme këto ide?; E treta: Si planifikoni që këto ide / dituri nxënësit ti zbatojnë.)

Tema 2

NOCIONET DHE MËSIMDHËNIA

NOCIONET DHE MËSIMDHËNIA

Fjalori Webster (Webster's Dictionary (1993, faqe. 469)) e definon **nacionin** „*dijëka e lindur në mendje; çfaqje, mendim ose qëllim; ide abstrakte e gjeneralizuar prej ngjarjeve konkrete*”. Me fjalë tjera, cilido objekt ose ngjarje që është e shënuar ose provuar dhe sqaruar ose përshkruar dikujt, mund të llogaritet si nocion. Shembull, vendet në lumenjtë të cilët kanë rënie vertikale dhe prej ku bie uji janë të njohur si ujëvare. Nocioni ynë është nxjerrur nga karakteristikat konkrete që janë tipike për të gjitha pamjet gjeomorfologjike në shtratin e lumejve të cilat i kemi grupuar në ujëvare. Poashtu, jo të gjithë individët kanë të njëjtin nocion / shfaqje për atë që një pamje gjeomorfologjike në lumejtë e bën ujëvarën. Duket e kuptueshme të thuhet se shkenctarët, të cilët i studijojnë ujëvaret, kanë ide më të rafinuara për këtë koncept nga joshkenctarët. Gjithashtu arsimtarët nga gjeografia do të kishin ide më të ndryshme për atë se çjan ujëvaret nga nxënësit e tyre. Në esencë, nocionet zhvillohen dhe rafinohen gjatë ballafaqimit të individit me përvojat që janë të lidhura me objektetose ngjarjet konkrete.

Sipas psikologëve të zhvillimit, ne i formojmë nocionet përmes interaksionit të katër faktorëve:

- (1) pjekuria fizike,
 - (2) përvoja fizike,
 - (3) interaksioni social dhe
 - (4) vetë-orientimi (Gallagher & Reid, 1981).
- Pjekuria fizike si faktor i parë, kryesisht i përket rritjes biologjike dhe zhvillimit të sistemit nervor qendror. Edhe pse të gjithë individët janë dëshmitarë të këtyre ndryshimeve fizike, diapazoni kohor i këtij zhvillimi dhe rritjeje varion prej individit në individ.
 - Përvoja fizike si faktor i dytë, i përket manipulimit me materiale, objekte ose ide.
 - Faktori i tretë, interaksioni social, paraqet diskutimin që paraqitet mes dy ose më shumë individëve gjatë diskutimit të tyre për ndonjë ide që i përket nocionit konkret ose temës.
 - Vetorientimi si faktor i katërt, paraqet procesin aktiv mental i cili shfrytëzohet gjatë zhvillimit dhe sqarimit të nocioneve.

Gjatë procesit të vetorientimit, individit e shfrytëzon njohurinë paraprake dhe informatat e fituara nga përvojat e reja fizike me qëllim të arritjes së kuptimit personal për nocionin konkret. Derisa individit ballafaqohet mentalisht me këtë njohuri, interaksioni social shërben si metodë për nxitjen e aktivitetit mental. Por, është me rëndësi të pranohet se pjekuria mentale e individit është e patjetërsueshme të jetë adekuate me provokimin mental konkret. Vetorientimi është i pavlefshëm kur personi përpiqet të shërbehet me aktivitet mental me të cilin akoma nuk është i gatshëm të ballafaqohet.

AKTIVITETI MENTAL GJATË FORMIMIT TË NOCIONEVE

Nocioni **ekuilibrum** (*equilibrium*) përdoret kur duket se interpretimi i përvojave fizike të një personi i përmbulon idetë e tij për nocionin konkret. Megjithatë, nëse personit i prezantohen informata të cilat nuk përputhen me kornizën e tij konceptuale/nocionologjike, personi do të provohet me jopajtueshmëri mentale ose **disekuilibrum** (*disequilibrium*). Në momentin e këtillë, personi ballafaqohet me mendimin ose ta hudhë poshtë jopajtueshmërinë ose ta ndryshojë mendimin e tij që të përballlet me konfliktin. **Asimilimi dhe akomodimi** (*përshtatja*) janë nocionet që shfrytëzohen për përshkrimin e aktivitetit mental që ndodhë kur individët e ndryshojnë mendimin e tyre. Gjatë asimilimit, individit e pranon dhe e kyçë informatën e re pa bërë ndryshime më të mëdha në të kuptuarit e tij për nocionin. Shembull, koncepti për topin të një fëmi i vogël është se ai është një objekt i rrumbullakët, kur të lëshohet, do të kërcejë rrugës vertikale. Kur ky fëmi do të ketë përvojë për herë të parë me topin e basketbollit, nuk do të ketë shumë vështirësi për ta asimiluar këtë objekt në nocionin e tij për top. Në këtë rast, mendja e fëmiut ngelë në ekuilibrum në raport me këtë nocion.

Akomodimi (*përshtatja*), nga ana tjetër, kërkon që personi ta shqyrtojë mendimin e tij për nocionin konkret dhe ta ndryshojë idenë e tij lidhur me atë nocion. Duke shfrytëzuar sërish topin si shembull, të provojmë se si ky fëmi i vogël mund ta përshtatë nocionin e tij për topin. Nëse të fëmiu nocioni për top akoma është – objekt i rrumbullakët që kërcen vertikalisht, atëherë, mendja e tij do të jetë në disekuilibrum (jobaraspeshë) kur të hasë topin për ragbi, sepse ai nuk është i rrumbullakët, por vezak, dhe nuk kërcen përherë vertikalisht kur të hudhet. Pikërisht për këtë, nëse ky fëmi dëshiron ta fusë topin e ragbit në nocionin e tij për top, duhet ta modifikojë idenë e tij fillestare se të gjithë topat janë të rrumbullakët dhe se kërcen vertikalisht. Nëse supozojmë se ai është mentalisht i përgaditur për tu përballur me këtë situatë, nocioni i tij për topin do të përfshijë edhe objekte specifike vezake të cilat i quajmë topa për ragb.

Situata hipotetike

Për të ofruar shembuj plotësues për atë se si formohen nocionet, ta shiqojmë situatën vijuese hipotetike. Në këtë shembull, një djalosh i ri e sqaron nocionin e tij për atë – pse klima mesatare ka katër stinë të vitit. Sikurse edhe shumica e nocioneve, nevojitet periudhë e caktuar kohore që fëmiu të përballlet për idenë e stinëve të vitit dhe një sërë përvojash të nevojshme që ti sqarojë idetë e tij. Derisa e lexoni shembullin vijues, ta keni para syshë se vera dhe dimri nuk shkaktohen nga distanca relative mes Tokës dhe Diellit. Në vend të kësaj, shkakun për stinët e ndryshme të vitit është i lidhur me këndin e pandryshuar të Tokës me boshtin e saj dhe raportin e këtij këndi me rrezet e diellit bien në Tokë në periudhë të ndryshme të vitit.

Një djalosh beson se verës Toka është më afër Diellit se sa dimrit. Për arsye se verës Toka është më afër Diellit, ajo është më e ngrohtë në këtë periudhë të vitit. (mendja e djaloshit është në ekuilibrum në raport me këtë nocion.)

Djaloshi bisedon me shokun e tij lidhur me këtë problem. Gjatë kohës së diskutimit, ata gjejnë fotografi ku ilustrohet lëvizja e Tokës rreth Diellit. Në fotografi, Toka është pak më e afruar kah Dielli në një periudhë të vitit. (Fotografia nuk i identifikon stinët e ndryshme të vitit në Tokë. Djaloshi e kyçë këtë fotografi në nocionin e tij për verë dhe dimër. (Edhe pse djaloshi ka futur informatë jokomplete, mendja e tij ngelë në ekuilibrum në raport me këtë nocion.)

Disa vite më vonë djaloshi bën një vizitë në muze. Në muze vështron demonstrimin e mënyrës në të cilën Toka është pjerrtësuar me boshtin e saj dhe raportin mes këndit të Tokës dhe revolucionin e saj rreth Diellit. Ky demonstrim tregon se vera dhe dimri nuk janë shkaktuar nga largësia relative e Tokës dhe Diellit, porse, vera dhe dimri janë rezultat i këndit nën të cilin rrezet e diellit bien në Tokë. Verës rrezet e diellit bien më direkt se sa dimrit. Në bazë të këtyre informatave të reja, djaloshi filon ta rishqyrtojë nocionin e tij për verë dhe dimër (disekuilibrum).

Djaloshi dëshiron të grumbullojë sa më shumë informata për stinët e vitit. Për këtë arsye, ai shkon në bibliotekë dhe gjenë libra lidhur me këtë temë. Në libër ai zbulon më shumë informata se ato të cilat i ka parë në muze. Libri, gjithashtu, sqaron se në të shumtën e rasteve, diagrami i orbitës së Tokës rreth Diellit është përpjekje e artistit ta paraqesë rrugën e Tokës vështruar anash, në vend të vështrimit nga lartë kah rruga e lëvizjes. Në këtë moment, djaloshi është mentalisht i përgaditur (pjekuria fizike) ta pranojë këtë informatë të re në nocionin e tij për verë dhe dimër. Me këtë pranim, mendja e djaloshit kthehet në ekuilibrum në raport me këtë nocion. Tani djaloshi ka nocion më të qartë dhe më përmbajtësor për atë pse në klimën mesatare paraqiten katër stinët e vitit.

Siç u ilustrua në shembullin e mësipërm, që djaloshi të zhvillojë nocion për stinët e vitit, i duheshte të vejë interaksion me bashkënxënësit tjerë dhe rrethinën e tij. Përmes këtij interaksioni, ai formon dhe sqaron idetë e tij për stinët e vitit. Edhe pse idetë e tij fillestare nuk ishin në pajtueshmëri me këtë – se si shkencëtarët do ta sqaronin këtë nocion, me kalimi e kohës, ai zhvilloi idenë që është më tepër në pajtueshmëri me atë të shkencëtarëve. Përsëri, bile edhe në këtë moment, ai me siguri nuk e ka njohjen e njejtë siç do ta kishte ndonjë shkencëtar. Pa pasur mëtej shkaqe dhe nevojë për ta rishqyrtuar këtë kuptim të tij për nocionin, te djaloshi mund të ngelë i pa ndryshuar ky nocion gjatë tërë jetës së mëtutjeshme.

NOCIONET DHE MËSIMDHËNIA E SHKENCAVE TË NATYRËS

Nocioni i stinëve të vitit është vetëm një shembull se si pikëpamjet e një personi mund të dallohen nga sqarimet e pranuar të fenomeneve të natyrës. Hulumtimet kanë treguar se nxënësit e të gjitha niveleve demonstrojnë “nociione alternative” për shumë përmbajtje dhe tema nga shkencat e natyrës. (Novak, 1983; 1987; 1993). Këto të dhëna japin në dijeni se, njëri prej principeve më të rëndësishme që duhet ndjekur një arsimtarë nga shkencat e natyrës është të mos paramendojë se nxënësit kanë kuptueshmëri të pranueshme, bile edhe për nocionet elementare shkencore. (Stavy, 1991). Poashtu, me vend është të konkludohet se arsimtarët e shkencave të natyrës duhet të fokusohen në mënyrat me të cilat i inkurajojnë nxënësit e tyre për ti shprehur në mënyrë të hapur njohuritë e tyre për konceptet që të mund ti diskutojnë idetë e tyre me bashkënxënësit tjerë dhe arsimtarët. Më tutje, me rëndësi të veçantë për arsimtarët është që t’u mundësohet nxënësve të tyre përvoja fizike adekuate dhe interaksion social që të mund të vazhdojnë me hulumtimin dhe rishqyrtimin e vlefshërisë së ideve të tyre. Me ndihmën e llojeve të këtilla të përvojave, nxënësit do të vazhdojnë ti sqarojnë dhe zhvillojnë nocionete tyre.

Vallë ndikon mënyra e prezentimit të përmbajtjes?

Pas sqarimit të dallimit të ndryshimeve të cilat llogariten si esenciale gjatë zhvillimit të nocioneve dhe shqyrtimit të situatës hipotetike, me të cilën u tregua se si një person mund të zhvillojë nocion, a mendoni se është me rëndësi të ndërmarrurit veprim në drejtim të përgaditjes së orëve mësimore në mënyrë specifike? Vallë ekzistojnë disa karakteristika specifike të orës që janë me rëndësi esenciale në dhënien e mundësisë që nxënësit të mund ti shqyrtojnë idetë e tyre reth përmbajtjeve ose temeve konkrete?

Që të mund ti analizojmë më tutje këto pyetje, të shohim tre orë me nxënës të mësimit lëndor. Secila prej orëve i përket përmbajtjes së njejtë. Mirëpo, gjatë prezentimit të përmbajtjes, para nxënësve është përdorur qasje e ndryshme. Shqyrtojeni secilin shembull dhe i kushtoni kujdes ngjashmërive dhe dallimeve mes tyre. Pastaj, përgjigjuni pyetjeve të cilat do ti keni pas orës së tretë.

ORA 1

Arsimtari A kërkon nga nxënësit e tij ta lexojnë pjesën nga librat e tyre ku bëhrt fjalë për kohën dhe klimën. Teksti përmban nocionet vijuese: atmosfera, dukuri atmosferike, metereologji, klima, elemente klimatike(metereologjike), faktorët klimatik dhe tipat klimatik.

Pasi që nxënësit t’i lexojne informatat në lidhje me nocionete lartëshenuara, arsimtari. A tregon fotografi, slajde, vizatime me shembuj te nocioneve te ndryshme dhe i diskuton specifikat e nocioneve.

Nxënësit ndahen në grupe. Për çdo grup jepet tekst plotësues nga revista të ndryshme, libra, enciklopedi dhe nga to kërkohet te punohet poster.

ORA 2

Arsimtari B fillon orën me zhvillim për kohën dhe klimën. Ju sqaron për nocionet: atmosferë, dukuri atmosferike, moti, meteorologjia, klima, elementet klimatike (meteorologjike), faktorët klimatik, tipat klimatik.

Si plotësim të igjëratisë së tij, arsimtari B përdorë fotografi, slajde, vizatime dhe video prezentim të shkurtër.

Pasi që prezentimi do të mbaroj për nxënësit, arsimtari B kërkon nga nxënësit të ndahen në grupe, me ndihmën e librit dhe teksteve të tjera të cilat ua jep (të nxjerura nga revista, libra dhe enciklopedi) të punojnë poster të vogël. Pastaj ai sqaron të gjitha lidhjet në mes nocioneve të lartpërmendura.

Si përfundim arsimtari B kërkon nga nxënësit e tij t'i lexojnë punimet dhe te japin përgjegje në pyetjet që arsimtari B ju parashtron.

ORA 3

Arsimtari B fillon orën nëpërmjet pyetjeve të drejtuara nga përdorimi i përvojave-paranjohuritë të nxënësve për klimën dhe kohën. Arsimtari B nxënësve ju prezenton një skemë me nocione: atmosfera, dukuritë atmosferike, moti, meteorologjia, klima, elementet klimatike (meteorologjike) faktorët klimatik dhe tipat klimatik dhe nga nxënësit kërkon të zbulojnë së paku diç për atë se çka paraqesin nocionete lartë shënuara. Pas kësaj arsimtari i orienton nxënësit të hulumtojnë duke përdorur librin, tekste plotësuese, fotografi, vizatime të cilat ua jep. Nga nxënësit kërkohet që për çdo kuptim të përgjigjen tekstualisht, t'i kërkojnë lidhjet e tyre të ndërsjellta, ngjajshmërisht dhe dallimet dhe ti paraqesin në tabelë.

Kur nxënësit do të përfundojnë me punën, diskutojnë-prezentojnë para klasës. Paralelisht me ta arsimtari B përpilon në tabelë listë të nocioneve dhe lidhjet në mes tyre, ngjajshmërit dhe dallimet. Atëher arsimtari B vë në përdorim nocionet: atmosferë, dukuri, meteorologji, klimë, elemente klimatike(meteorologjike), faktorë klimatik dhe tipa klimatik. Nga nxënësit kërkohet që të lexojnë pjesë nga librat e tyre të cilët përmbajnë informacione për nocionet e lartpërmendura. Në fund, nga nxënësit kërkohet të parashikojnë se cilët lloj të tipave klimatik takohen në vendin tonë dhe t'i sqarojnë shkaqet për paraqitjen e tyre.

PYETJE PËR DISKUTIM

1. Krahasoni dhe bëni dallime në mës njesive të cilët janë përshkruar më lart. Me çka këto orë janë të ngjajshme, e me çka të dallueshme?
2. Cila nga këto orë e ka formatin më të mirë për të zbuluar njohuritë paraprake të nxënësit?
3. Sipas Jush, cila nga këto orë ofron mundësi më të mirë që nxënësit të zhvillojnë nocione për atmosferë, dukuri atmosferike, moti, meteorologjia, klima, elemente klimatike(meteorologjike), faktorë klimatik dhe tipa klimatik?
4. Sqaroheni përgjigjen tuaj.
5. Duke supuzuar se qëllimi kryesor i mësimdhënies është që nxënësit të zhvillojnë kuptueshmëri të nocioneve në disiplin të dhënë, a mendoni se ekzistojnë karakteristika konkrete të cilat duhet të jenë të përmbajtura në të gjitha planet e mira për orë mësimore? Nëse është ashtu, atëher cilat janë ato karakteristika?

PESË TEMAT TË GJEOGRAFISË

Gjeografia është shkencë e cila jep mundësi të mëdha për hulumtimin e natyrës - hapsirës dhe mardhënjet interaktive të cilat zhvillohen në të. Gjatë përgatitjes të përmbajtjes mësimore të arsimtarëve mund tju shërbëjnë 5 temat e gjeografisë si vegël e vlefshme në procesin e mësimin për hapsierën dhe vendin, por edhe kuptueshmërinë e stereotipeve në arsimin nga gjeografia, futjen e ideve të reja ides siç janë rajonet perceptive, mapat mentale etj.

Për nevojat konkrete të arsimtarëve në vitin 1984 në SHBA ishte botuar një publikim i veçantë i titulluar – kahjet për arsimimin nga gjeografia dhe përmbajtja e saj si: **Pesë temat e gjeografisë**³. Ato tema janë:

- **Lokacioni**
 - Lokacioni relativ
 - Lokacioni bsolut

- **Vendi**
 - Karakteristikat njerëzore
 - Karakteristikat fizike

- **Interaksioni mes njeriut dhe mjedisit/natyrës**
 - Njerziti i përshtaten mjedisit
 - Njerziti e ndryshojnë mjedisin.
 - Njerziti varen nga mjedisi

- **Lëvizja**
 - njerëz
 - të mira
 - ide

- **Rajonet**
 - Farmal
 - Funkcional
 - Perceptiv

³ Lisa Keys-Mathews, Pesë temat nga gjeografia, Universiteti i Alabamës së seksioni i gjeografisë.

Lokacioni

”Ku gjendemi? Më të cilën pëgjigjet tema *Lokacioni*. Lokacioni mund të jetë absolut apo relativ. Këto lokacone, çfarëdo qofshin relative apo absolute, janë lokacoione të njerzve apo të vendeve.

Lokacion absolut është gjërësi apo gjatësi gjeografike (lokacion global) apo adresë e rrugës. (lokacion lokal)

MANASRIRI gjendet në $41^{\circ}10'$ gjërësia gjeografike veriore dhe $21^{\circ}20'$ gjatësi gjeografike lindore.

SHTIPI gjendet në $41^{\circ}52'$ gjërësi gjeografike veriore dhe $22^{\circ}05'$ gjatësi gjeografike lindore

LIQENI DOJRANIT gjendet në $41^{\circ}13'$ gjërësi gjeografike veriore dhe $22^{\circ}45'$ gjatësi gjeografike lindore

Lokacioni relative janë të pëshkruar me vende karakteristike, kohë, kahje apo largësia prej njërit vend deri te tjetri dhe mund të lidhin vend të caktuar me tjetrin.

Nga Ohri deri në manastirin Sh.Naum duke lëvizur me automobil nëpër rrugën regjionale, të asfaltuar me gjatësi 20km arrihet për 30min. (gjysmë ore).

Vendi

Çfarë vendi është ai? Në çka do të rikujtohesh kur do të paramendosh Brazilin, Japoninë, Zvicrën, Kinën, Rusinë, Keninë, Arabinë Saudite, Zelandën e Re, Maqedoninë?

Vendet kanë karakteristika **njerezore** dhe **fizike**, por edhe fotografi.

Karakteristikat fizike përfshijnë malet, lumenjtë, tokat, plazhet dhe botën shtazore. Vendet gjithashtu kanë edhe karakteristika njerëzore. Këto karakteristika janë udhëhequr nga idetë dhe aktivitetet e njerëzve, të cilët shkaktojnë ndryshime në mjedisin, siç janë: ndërtesa, rrugë, veshje apo shprehi ushqimore.

Karakteristikat njerëzore Fotografinë të cilën e kanë njerëzit për ndonjë vend bazohet në përvojat e tyre, si intelektuale, ashtu edhe emotive. Përshkrimi i njerëzve për ndonjë vend, zbulon vlefshmërin, qëndrimet dhe perceptcionet për ata njerëz.

Si është i lidhur qyteti ynë me vendet tjera? Cilat janë karakteristikat fizike të Malit Sharr? Si ndikojnë këto në jetën tonë?

Interakcioni mes njeriut dhe mjedisit

Si ndikojnë reciprokisht njerezit dhe mjedisi? Ne e ndërrojmë mjedisin, kurse ndonjëherë Nëna naturë e kthen prapa. p.sh. tërmeti në Indonezi, vërshimet në Evropën e mesme, erupcioni vullkanik në Etnë, zjarret në Greqi apo rëshqitja e tokës në Kili etj.

Egzistojnë tri koncepte kyçe të interakcionit në mes njeriut dhe mjedisit:

- Njerëzit i përshtaten mjedisit
- Njerëzit e ndërrojnë mjedisin
- Njerëzit varen prej mjedisit

Njerëzit janë të varur nga lumi Danub për ujë dhe transport. Njerëzit e ndërrojnë mjedisin duke ngrohur dhe ftohur ndërtesat për shkak të komoditeti. Ata adaptohen në mjedisin duke veshur rrobe të cilat janë të përshtatshme për verë apo dimër, shi - apo diell.

Te gjitha vendet në Tokë kanë përparsitë dhe të metat e veta për qëndrim të njerëzve. Ajo që është përparsi për dikë mund të jetë mangësi për dikë tjetër. Dikush e don harene e qyteteve të mëdha, kurse dikush e don largësinë. Mjedisi nuk është vetëm druri, lumë i shpejtë, ndonjë buf, kaproll dhe pyje të shiut. Mjedisi është ndjenjë. Si është mjedisi në një qytet të madh si: Los Angeles? Sidney? Kairo? Shkupi?

Sikur të kishe zgjidhje ku do të jetoje ti? Pse? Çfarë është ai mjedis? Si komunikojnë njerëzit me mjedisin? Si ndikojnë te ne karakteristikat fizike të tij?

Si e kemi ndryshuar apo përshtatur rrethin? P.sh. në Sudan, edhe pse mendohet se është shkretëtirë, toka ushqen fermerët dhe blegtoret nomad. Njerëzit dhe shtazët u janë përshtatur klimës së nxëhtë e të thatë. Apo në Tibet, edhe pse mjedisi është i ashpër me klimë të thatë dhe të ftohtë, prapsepapë njerëzit dhe shtazët janë përshtatur. Toka punuese e mangët njerëzit i ka përshtatur që të miren me blegtori nomade ekstenzive.

Lëvizja

Lëvizja e njerëzve, importi dhe eksporti të të mirave dhe komunikimi masiv ka luajtur rol të rëndësishëm në formimin e botës sonë. Njerëzit rugëtojnë prej një vendi në tjetrin dhe komunikojnë. Jetojmë në fshat global dhe ekonomi globale.

Njerëzit komunikojnë ndërmjet veti përmes lëvizjeve. Ata janë të shpërndarë në mënyrë jotë barabartë në tokë për shkak të mjedisit, por edhe për atë se jemi qenie njerzore. Ndërmjet veti komunikojmë nëpërmjet udhëtimit, tregëtisë, informacioneve (E-mail) dhe ngjarjeve politike.

Nuk lëvizim vetëm njerëzit por edhe idetë; lëviz moda; trendet. Që është shembull për lëvizje idesh? Moda? Trend? Si varem prej njerëzve nga vendet tjera? Si do të ndërroheshte jeta jonë nëse ndërroheshim mundësitë për lëvizje? Çka do të ndodhte nëse do të udhëtonim me deve apo kalë? Si lëvizim nga një në vendë tjetër? Si në të vërtetë vimë deri te ushqimi? Cilat janë përparësitë e lëvizjes.

Rajonet

Rajoni është njësi themelore për mësimin në gjeografi. Rajoni është territor i cili ka një tërësi koherente në aspektë të sundimit, gjuhës, apo lloj toke apo situatash. Rajoni është koncept njerëzor i cili mund që të hartohet apo analizohet.

Ka tre tipa themelor të rajoneve:

Rajone formale, janë ato të cilat janë të definuara nga qeverit apo kufit administrative (siq janë SHBA/të, Brazili, Italia, Maqedonija). Këto kufijë rajonal nuk diskutohen, prandaj rajonet fizike bëjnë pjesë në këtë kategori (siq janë malet Shkëmbore, shtetet e Liqeneve të Mëdha, shtetet e Saharës, shtetet e Ballkanit).

Rajonet funksionale, janë ato që janë të definuara sipas funksionit (Teritor zyrtar i avioshërbimit Nacional, shtetet e CEFT/ës, shtetet e Komomvelltit, shtetet e OPEKU/t. Nëse funksioni pushon së ekzistuesri, pushon së ekzistuari edhe rajoni.

Rajonet perceptive (vernakulare), janë ato të cilat kanë definim labil në perceptim të njerëzve (Jugu, Lindja e Afërme, Jug Perendim, Lindja e Mesme),

Në cilin rajon jetojmë ne? Çfar rajoni është aji? Cilat janë karakteristikat e tijë? Jug, rajon jugperendimor? Cilat shtete për Juve janë jug? Veri lindje?Lindja e afërt? Cilat karakteristika dhe perceptime i përgjigjen këtyre rajoneve?

PLANIFIKO ORË MËSIMORE NGA GJEOGRAFIA DUKE PERDORUR PESË TEMAT E GJEOGRAFISË

Shfrytëzo njësi mësimore, përmbajtje nga programi mësimor nga gjeografia. Si pas zgjedhjes suaj, mund të përdorni libra dhe literaturë tjetër, përdorni interneti kërkues Google Earth, Yahoo, Wikipedia etj. Në elaborimin tuaj mund të integroni disa përmbajtje në mardhëniet në mes njeriut dhe mjedisit dhe lëvizja e tij në rajon.

SHEMBULL:

Gjat përunimit të nocionit gjeografi fillohet nga mardhëniet interaktive-lokacion-vend-njeri-mjedisi-lëvizja deri tek rrajoni (Danubi, Liqenet e Mëdha, Deti Mesdhe, Alpet, ultësira e Panonisë, Sahara, Njujork, Tokio, Paris, qytet më të mëdha Shkupi, fushëgropa-Pellagonia etj.

Gjat planifikimit të orës mësimore zbato Pesë Temat e gjeografisë (lokacioni, vendi, interakcioni njeri-mjedisi, lëvizja dhe rajoni).

Punoni në grupe. Xhdo grupi i jepni angazhime të ndryshme – të masin largësi

të caktojnë koordinata, lartësi mbidetare, të kërkojnë shënime për rajonin, të japin përshkrime për teritorin, të incizojnë, tekste, fotografi, harta etj. Rrezulltatet e veta në mënyrë të përpunimit (prodhim) ti prezantojnë para kolegëve.

Nëse përcaktoheni çdo orë, ta planifikoni dhe ta realizoni me ndihmën - Google Earth duhet ti dini hapat e ardhshëm:

- Hapi 1** - I parë hyni në Internet dhe kërkoni Google Earth, (Google Earth Galery, Google Earth 4.2.)
- Hapi 2** - tani jeni në Google Earth në monitorin lajmrohet pamja e tokës e shiquar nga kosmosi, nga njihet Amerika Veriore. Në pjesën për kërkim Search shënime emrin e qytetit të cilin doni ta kërkoni, dhe shtypni Search apo Enter në tastierën në kompjuter.
- Hapi 3** - Në monitor ngadal lajmrohet pamja e vendit shiquar nga 20-30km lartësi. Në monitor majtas poshtë shiqohen edhe koordinatat gjeografike - gjatësia, gjerësia, lartësia mbidetare. Me ndihmën e tre veglave që gjenden lartë djathtas në monitor respektivisht pjesa që është paraqitur (vegla për zumim 3D, dhe kompas lëvizës). lehtë mund të ofrohemi nga vendi të fitoni shiquim tredimensional nga anë të ndryshme të botës. Gjithashtu kur të ofrohemi deri tek vendi mund të shihni vendbanime fqinjë pamjen e relievit, fotografi të ndryshme etj. Në kutin e veglave, më karakteristike është vegla Show Ruler - vizore në përmes së cilës mundeni të matni largësi prej një pike në tjetrën, respektivisht të bëni llogaritë të largësive të ndryshme.
- Hapi 4** - Nëse hapni kovertë-folder mundeni në folder të inçizoni, tekst, harta të rajoneve, qytetin, rrugët etj.

Hapi 5 - Kështu materialin e përpunuar kështu, nxënësit mund ta prezentojnë në orën tjetër nëpërmjet Power-Point apo të punojnë një poster të shtypur.

SHEMBULL:

Tema mësimore: UJËRAT - GJEOGRAFIA RAJONALE - Amerika veriore

Përmbajtja mësimore: Liqenet - Liqenet e mëdha

Qëllimet e përmbajtjes mësimore:

Nxënësi do të mund të:

- ta përshkruajnë nocionin Liqenet e Mëdha
- t'i përvetësojnë karakteristikat e Liqeneve të Mëdha
- ta zbatojë njohurinë e tyre për Liqenet e Mëdha nëpërmjet njohjes së tyre kur të shikojnë në hartën gjografike, fotografi apo videoklipe.

Lloji i punës:

punë në grupe (4-6 anëtarë) (secili anëtar i grupit ka angazhime të veçanta - *një udhëheqës - navigator, i dyti - bënë matje, llogaritë, i treti - vizaton, plotëson-mbledhës informatash, i katërti - krahason, i pesti - rendit - rregullon informacionet dhe i gjashti - prezenton.*

Mjetet dhe materialet e nevojshme për mësim:

- kompjuter të lidhur me internet (shfrytëzim të Google Earth)
- hartë fizike të Amerikës Veriore
- atlas gjografik i botës
- hartë memce për Liqenet e Mëdha
- Tekst për Liqenet e Mëdha (të zbritura nga Wikipedia, apo kërkues tjerë të ndryshëm)

Përshkrim i aktiviteteve të arsimtarit dhe nxënësve gjatë orës:

Tregoni nxënësve harta gjografike nga Amerika Veriore dhe disa fotografi të ndryshme të Liqeneve të Mëdha.

Pyetje: - Ndërmjet cilave shtete shtrihen Liqenet e Mëdha?

- Nëse dine diçka për Liqenet e Mëdha kërkoni nga nxënësi ta shfrytëzojnë njohurinë e tyre.
- Pas përgjegjeve të nxënësve tregojuni se në këtë orë do të bëjmë një hulumtim për Liqenet e Mëdha dhe për rëndësinë e tyre në ato pjesë të botës.
- Ndani nxënësit në grupe, kërkoni nga çdo grup të punonë deturat që vijojnë:

Secili grup ia shpërndani materialin e duhur (hartat memece për Liqenet e Mëdha.)

Pas kësaj nxënësve ua sqarojmë se si ta plotësojnë hartën memece. Ua tregojmë nxënësve se pjesën më të madhe të hulumtimit duhet të bëjnë nëpërmjet internetit \Google Earth. Në fund, u tregojmë nxënësve që të hapim folder në të cilin do të fusim të gjitha gjërat për të cilat mendojmë se do të ju duhen për posterin e tyre gjat prezencimit.

Shënoni nocionet: Liqenet e Mëdha - Iri, Hjuroni, Miçigeni, Ontario, Liqeni i Sipërm, Nxënësve në pikë të shkurta sqarojmë karakteristikat kryesore të Liqenet e Mëdha.

Mëdha nxënësit në bazë të hulumtimeve nga interneti Google Earth të bëjmë, 3D fotografi, harta për vendodhjen e krahinës e përdorim kompjutorin, kompasin lëvizës, incizojnë në folder fotografi të ndryshme harta të vendodhjen e rajonit, masim distanca, përcaktojnë lartësit mbidetare, koordinata gjeografike, shfrytëzojnë tekste dhe printojnë pjesë interesante nga rajoni, liqenet, qytetet, objektet prodhues etj. Pas kësaj shkëmbejnë diskutime të shkurta për karakteristikat e Liqeneve të Mëdha në fund në bazë të të dhënave të cilat i kanë shënuar dhe në bazë të tekstit Liqenet Mëdha arsimtari kërkon nga nxënësit të punojnë poster në të cilin do të vejnë të gjitha të dhënat që në hartë i kanë incizuar në follderet e tyre.

Gjithashtu, është e rrugës që një pjesë nga të dhënat ti lënë në tabelë apo të punojnë në grafikun.

Kërkoni nga nxënësit në periudhat e ardhshme të lexojnë material të përshtatshëm për Liqene të Mëdha me çka posterin për këto liqene do të jetë më i plotë. Përcaktoni kohë orë plotësuese për prezencim të punës, dhe personat të cilët do të prezencojnë punimet – posterët e tyre.

Tema 3

CIKLI I TË MËSUARIT

QËLLIMET E TEMËS

QËLLIMET E TEMËS

Në këtë temë nxënësit:

- ❑ do të njihen më ciklin e mësimit në katër faza
- ❑ do ta shqyrtojnë zbatimin e kësaj metode në realizimin e përmbajtjes mësimore nga gjeografia
- ❑ do të vërejnë se cikli i mësimit themelohet në qëllimet psikologjiko-zhvillimore
- ❑ do të fitojnë aftësi për planifikim të orës mësimore sipas ciklit të mësimit
- ❑ do t'i vështrojnë relacionet e ciklit të mësimit me mësimin aktiv

Lexoje tekstin e shkurtër dhe identifikoj fazat e orës

Për realizimin e këtij aktiviteti së pari lexoni tekstin dhe mendoni për fazat e orës punoni individualisht e pastaj mendimin tuaj lidhur me fazat e orës ta shkëmbesh nëpërmjet diskutimeve në nivel të grupit

Identifikimin e fazave të orës mund t'i shënoni në skaj të tekstit dhe kur të jeni të gatshëm caktoni personin që do t'i prezentojë mendimet e juaja para grupeve tjera.

Përmbajtja mësimore: SHPERNDARJA E KONTINENTEVE DHE OQEA NEVE

Asimtari kërkon nga nxënësit ta vërejnë globin e tokës dhe hartën gjeografike të botës dhe të bëjnë dallimet dhe ngjajshmëritë. Të gjitha vërejtjet t'i përshkruajmë në fletore. Nxënësit e vërejnë globin, hartën gjeografike, në hartën gjeografike të botës në atlasat dhe në fletoret e tyre bëjnë shënime. Nxënësit arsimitari ua sqaron nocionet kontinente, oqeanet, jep karakteristikat të caktuara dhe i tregon në glob, Pastaj, nga nxënësit kërkon që të identifikojnë kontinentet dhe oqeanet në hartën gjeografike të botës.

Arsimtari nxënësit u sugjeron që nëpërmjet diskutimeve të shkëmbejnë vështrimet dhe vërejtjet në lidhje me kontinentet dhe oqeanet. Nga përgjigjet e nxënësit duhet të shikohet se ata në hartën gjeografike të botës dhe në glob dinë t'i gjejnë kontinentet: Europën, Azinë, Afrikën, Amerikën Veriore, Amerikën Jugore, Australinë dhe Antartikun; oqeanet: Oqeanin e Qetë, Atlantik, Indian dhe Oqeanin e Ngirë Verior dhe dinë karakteristikat të caktuara të nocioneve të paraqitura

Nga nxënësit, kërkohet që nga harta gjeografike e botës që gjendet në atlas, që nëpërmjet letrës së tëjdukshme të kopjojnë kontinentet dhe oqeanet, si dhe t'i shënojnë emrat e tyre dhe sipërfaqen (të dhënat nxënësit do të nxjerrin nga libri, nga atlasit apo arsimitari do të shënon në dërrasën e zezë). Poashtu, nga nxënësit kërkohet t'i gjejnë dhe t'i shënojnë emrat dhe të dhënat, për lartësitë më të mëdha të kontinenteve edhe thellësitë më të mëdha të oqeanëve, në hartat gjeografike të kopjuara të botës. Nëse për këtë aktivitet nuk kanë kohë, atëherë ajo jepet për detyrë shtëpie.

Cikli i të mësuarit është model instruktiv, i zhvilluar për t'i përshtatur ndryshimet gjatë formimit të nocioneve të identifikuar nga psikologët e zhvillimit. Ky model rrjedh nga vitet 60 të shekullit të kaluar, nga programi i shkencave të natyrës të arsimit fillor i njohur si studim për përmirësimin e kurikulimit nga shkencat e natyrës ose SCIS (SCIS, 1974). Cikli fillestar i të mësuarit përbëhet nga tre faza: hulumtimi, kreacioni dhe zbulimi. Verzioni fillestar i ciklit të të mësuarit, disa herë ka qenë i përmirësuar dhe reviduar. Shembull, Karplus etj. (1977), vuri në përdorim versionin në tre faza që përfshinin: hulumtimin, futjen e nocionit, aplikimin e nocionit. Rener dhe Marek (1988) i shfrytëzuan nocionet hulumtim, shpikje terminuale dhe zgjerim i idesë, me qëllim të përshkruarjes së versionit të tyre për ciklin e të mësuarit. Bibi dhe Troubrixi (1990), propozuan model prej pesë niveleve të quajtur "pesë E" (engage, explore, explain, elaborate, and evaluate), gjegjësisht fazat e përshkruara janë: angazhimi, hulumtimi, sqarimi, detalizimi dhe vlerësimi. Barman (1997) ofron version tjetër të ciklit të të mësuarit. Verzioni i Barmanit përbëhet prej katër fazave të cilat bashkëngjeshin: angazhimin hyrës, hulumtimin, diskutimin dhe aplikimin.

Edhe pse cikli i të mësuarit ishte modifikuar në disa versione të ndryshme, secili adaptim është në pajtueshmëri me mënyrën me të cilën shkencat kognitive e shikojnë të mësuarit dhe zhvillimin e nocioneve. Më tutje, versionet e mëvonshme shprehin porosi konkrete nga hulumtuesit të cilët i mësuan nocionet alternative nxënësve, sikurse që janë vënia e strategjive me të cilat nxënësit i zbulojnë nocionet e tyre vijuese, si dhe kuptimi i fenomeneve natyrore që ofrojnë ndodhi të shumfishta për të cilat nxënësit mund të përdorin nocione nga leksioni në situata të reja.

Cikli i të mësuarit është model shumë i përshtatshëm i mësimdhënies. Ai është në pajtueshmëri me teorinë e pranuar të të mësuarit dhe mund t'i ngërthejë trendet aktuale siç janë të mësuarit kooperativ dhe pyetje nga shoqëria shkencorë-teknologjike. Më tej, studimet hulumtuese tregojnë se cikli i të mësuarit mund të jetë model efektiv gjatë të mësuarit të nocioneve dhe shkathtësive të të mësuarit, gjatë zhvillimit të qëndrimeve pozitive për shkencat e natyrës dhe gjatë ballafaqimit me ndryshime në nocione. Cikli i të mësuarit është strategji e përshtatshme e mësimdhënies e cila u mundëson arsimtarëve që t'i zgjedhin me kujdes llojet e përvojave të të mësuarit për të cilat ata mendojnë se janë të rëndësishme për nxënësit e tyre.

Pesë arsytet për rëndësinë e ciklit të mësimit:

- ❑ Cikle të mësimit është e lidhur me aktivitete mentale gjatë formimit të nocioneve duke filluar nga grupi i lëndeve natyrore
- ❑ Cikli i mësimit bazohet mbi përkurisë fizike përvojës fizike interakcion social dhe vetëorjentim
- ❑ Cikli i mësimit është ngusht e lidhur me teorinë tjera të mësimit, më teorinë personale, konstruktive, teori më orientim social, teori me orientim memorigjik
- ❑ Cikli i mësimit është kompatible edhe me dy trende rrjedhë në përsosje të grupit të lëndeve natyrore-mësimi kooperativ dhe shoqëri teknologjike mësimore (S-T-S)

- Cikli i mësimit në përvetësimin e përmbajtjeve nga grupi i lëndeve natyrore është efikas dhe metod superiore në krahasim me metodat me konvencionale (metodat e mësimit, shfrytëzimi i librit, detyrë me shkrim, demonstrim dhe diskutim).

KATËR FAZAT E CIKLIT TË TË MËSUARIT

Karakteristikat e secilës nga katër fazat e verzionit të Barmanit për ciklin e të mësuarit janë dhënë më poshtë. Poashtu, është prezentuar leksion me qëllim të demonstrimit se si katër fazat e këtij cikli të të mësuarit janë të lidhura reciprokisht për tu formuar një përvojë e artikuluar e të mësuarit.

FAZA I - ANGAZHIMI HYRËS

Në këtë fazë zhvillohen ecuri të cilat duhet t'u ndihmojnë nxënësve që ti hetojnë nocionet e paformuluara dhe nocionet e gabuara. Me rëndësi është që mos t'i gjykojmë idetë e nxënësve.

FAZA II - HULUMTIMI

Nxënësve u prezentohet problemi ose detyra e cila është aq e hapur që ti inkurajojë nxënësit për të përdorur më shumë veprime të ndryshme, por nga ana tjetër, mjaft konkrete për të ofruar ndonjë orientim. Aktivitetet që përdoren në këtë fazë ofrojnë bazë për nxënësit që ti rishqyrtojnë idetë e tyre vijuese në raport me përmbajtjen e leksionit dhe të formojnë kornizë për zhvillimin e nocioneve dhe terminologjive të reja në pajtueshmëri me temën e leksionit.

FAZA III - DISKUTIMI

Arsimtari i kyçë nxënësit në diskutim lidhur me zbulimet e tyre dhe pyetjet të bazuara në hulumtimin. I nxitë nxënësit që në mënyra të ndryshme të kërkojnë informata plotësuese të sqarojnë se si ky proces e ka ndryshuar njohuritë paraprake të tyre.

FAZA IV - APLIKIMI

Nxënësve u prezentohen shembuj plotësues për nocionet kryesore të leksionit, ose u parashtrohet detyrë e re e cila mund të zgjidhet me informata që fitohen nga fazat paraprake të leksionit. Në rastin ideal, një ose më shumë prej përvojave gjatë aplikimit do të kenë lidhje direkte me jetën e përditshme të nxënësve. Edhe pse figura 1 tregon se vlerësimi mund të paraqitet në secilën prej këtyre fazave, aktivitetet për aplikim ofrojnë mënyrë të shkëlqyer për vlerësim të bazuar në interpretimin.

Cikli i të mësuarit në katër faza



SHEMBULL I NJËSISË SIPAS CIKLIT TË TË MËSUARIT

Tema e njësisë: TOKA

Qëllimet e njësisë

Nxënësi do të mund të:

1. Ta klasifikojnë tokën si argjil, rërë apo humus.
2. T'i krahasojmë dhe ti përshkruajn dallimet në mes karakteristikave të (rërës, argjilit, humusit)
3. Ti zbatojmë [diturit] e tyre për karakteristikat e rërës, argjilit, humusit për zgjidhjen e problemve të lidhur me shfrytëzimin e tokës.

Materiali i nevojshëm: (per katër nxënës)

- ❑ 3 shembuj te tokes të ndryshme dhe të pa shënuara (rërë, argjil, humus)
- ❑ lup dore
- ❑ cilindër të graduar (10 ml)
- ❑ 3 hinka me grykë të shkurtër (dijametër 65mm)
- ❑ 3 epruveta (150ml)

- një mbajtës të epruvetes
- 3 cope letër-filtruese (dijameter 11cm)
- Mapë nga rrethi i Liqenit të Shotës (faqe 35)

Angazhimi hyres

Tregojuni nxënësve shembuj nga toka

Pëyesim: Ç'është kjo? Si u krijua? Kërkoni të prshkruajnë si paraqitet toka në oborin e shkollës, apo në fqinjësinë e tyre.

Hulumtim

Ndani nxënësit në grupe nga 4 kërkoni nga çdo grup të bëjë detyrat e ardhshme:

1. Shikoni çdo ekzemplarë të tokave vëreni ngjyrat dendësinë dhe madhësinë relative të çdo shembulli
2. Vendosni epruvetat në mbajtësin e epruvetes
3. Veni pjese të filterit në gjdo hinkë dhe veni nga një hinkë në gjdo epruvete
4. Mbushni çdo hinkë me ekzemplarëtë ndryshëm të tokave (ngadal shtypni çdo ekzemplarë që të largohet ajri i tepërt)
5. Mbushni me ujë nga 10ml në çdo hinkë masim sasine e ujit e cila kullohet nëpërmjet shembujve për kohë prej 5 min

Diskutim

Nxënësit le ti diskutojnë vrejjet e tyre.

Shënoni nocionet *rërë*, *humus* dhe *sqaroni* karakteristikat për çdo lloj të këtyre tokave.

Nxënësit të identifikojnë se cila prej shembujve është rërë, argjil, humus.

Sqaroni pse toka humuse është më e mirë për punim. Diskutoni poashtu, pse argjili nuk është e përshtatshme për ndërtim dhe struktura tjera (p. sh. argjili zgjerohet kur është i lagësht, tkurret kur është i thatë. Kjo mund të shkaktojë probleme serioze strukturore tek ndërtimet).

Pastaj, nxënësit le ti shfrytëzojnë të dhënat e tyre nga aktiviteti gjatë diskutimit për kapacitetin e mbrojtjes së ujit për çdo lloj toke (p.sh. cila toke tregojnë kullim më të mirë? Cilit lloj i duhet kohë më tepër për kullim? Kërkoni nga nxënësit të lexojnë materiale të përshtatshme për atë se si llojet e ndryshme të tokës ndikojnë në zhvillimin e ujërave dhe rrëshqitjen e tokave.


Zbatim

Ndani nxënësit në grupe nga 4. Kërkoni nga çdo grup të **zgjedh - modelues, mbedhes të informatave, këshilltar profesional** dhe **prezentues**. (Modeluesi e organizon grupin dhe i përcjell aktivitetet të grupit, mbedhesi i informatave shënon informata apo idetë të cilat i gjeneron grupi).

Prezentuesi dhe këshilltari teknik do të jenë përgjegjës për rreth prezentimit të shpikjeve dhe të grupit dhe këshillat deri te tërë klasa.

Siguroni nje mapë nga rrethi i Liqenit të Shotës për gjdo grup ky rreth është i preferuar për kopshte ndërtim vendbanimesh (shtëpi)dhe parqe rekreative detyra për çdo grup është të përcakton vendet të rrethit të liqenit te Shotës të cilat janë më të përshtatshme për kopsht për ndërtim vendbanimesh dhe ndërtim parqesh. Çdo grup duhet të shfrytezojë diturite e veta për llojet e tokave dhe kullueshmerinë gjatë formimit të planeve. Të tyre pritet që këshilltari teknik dhe prezentuesi tu ofrojnë sqarim të qëndrueshem për planin e propozuar.

MAPË NGA RRETHI I LIQENIT TË SHOTËS



LIDHSHMËRIA E CIKLIT TË TË MËSUARIT DHE TË FORMUARIT E NOCIONEVE

Faza e angazhimit hyrës u ofron nxënësve mundësi për ti shprehur idetë e tyre lidhur me përmbajtjen/temën e leksionit dhe arsimtarit i ofron pasqyrë për njohurinë para-prake të nxënësve lidhur me lëndën e dhënë. Ky lloj diskutimi është me rëndësi – hap i parë në të mësuarit. Ai është një lloj interaksioni social i cili u ndihon individëve që të fillojnë të mendojnë për atë që e dinë dhe për atë që nuk e dinë nga lënda konkrete.

Faza e hulumtimit, u ofron nxënësve përvoja fizike dhe interaksion social. Nxënësit gjatë kësaj faze mund të provojnë disekuilibrumin. Dy segmentet e fundit; diskutimi dhe faza e aplikimit, ndihmojnë për vetë-orientim, duke ofruar interaksion plotësues social dhe mundësi që nxënësit ta zgjerojnë nocionin/nocionet në situata të ndryshme. Në vend të një aktiviteti për aplikimin, propozohet që nxënësit ta përdorin nocionin kryesor të leksionit në disa aktivitete. Këto mundësi përfshijnë lidhshmëritë me gjërat me të cilat takohen në jetën e përditshme. Individët të cilët janë të kyçur në hulumtimin e nocioneve besojnë se nxënësve u nevoiten disa mundësi për të aplikuar nocionin / nocionet nga leksioni, përfshirë këtu edhe përvoja të cilat mund të përdoren në jetën e tyre private. (Osborne & Freyberg, 1985). Besohet se këto përvoja u ndihmojnë nxënësve që ti rishqyrtojnë ose sendërtojnë nocionet e tyre për fenomenet konkrete natyrore dhe shërbejnë si mjet i mirë për vlerësimin e suksesshmërisë së leksionit.

Arsimtarët të cilët e shfrytëzojnë ciklin e të mësuarit duhet ti përkushtojnë kujdes të posaçëm përmbajtjes së leksioneve të tyre me qëllim që të mos i nënvlerësojnë ose mbivlerësojnë aftësitë mendore të nxënësve të tyre.

CIKLI I TË MËSUARIT DHE TEORITË TJERA TË TË MËSUARIT

Sikurse që u përmend paraprakisht, cikli i të mësuarit në fillim bazohet në teoritë e psikologjisë zhvillimore. Por, kur njeriu do të hulumtonte teoritë tjera më të rëndësishme të të mësuarit, do ta kishte parasyshë se kjo qasje e arsimimit është në masë të madhe kompatible me (1) *teorinë personale konstruktiviste*, (2) *teorinë sociale e orientuar*, (3) *teoritë e orientuara neurologjike* dhe (4) *teorinë e inteligjencës multiple*. Paragrafët tjerë, në pika të shkurta, i sqarojnë idetë kyçe të secila prej këtyre katër teorive dhe përmendin në cilat mënyra cikli i të mësuarit i përmbanë secilën prej tyre.

1. Teoria personale konstruktiviste

Sipas aspektit konstruktivist të të mësuarit, secili person formon modelin e tij të botës. Ky model, me kalim të kohës bëhet objekt i ndryshimeve, sepse individi vazhdimisht e kontrollon. Konstruktivistët besojnë se individi krijon dituri personale për fenomenet natyrore përmes rrugës së procesit aktiv, kreativ, racional, emotiv dhe pragmatik. Nëpër këtë proces, personi zhvillon, provon dhe mënjanon ose modifikon shumë ide për atë se si funksionon bota. Ky „testim idesh” mund të përforcohet përmes interaksionit me individ tjerë ose nëpër aktivitete fizike të ndryshme.

Cikli i të mësuarit promovon interaksion social dhe përvoja fizike. Faza e hulumtimit u ofron nxënësve mundësi që aktivisht të hulumtojnë fenomenet natyrore. Në këtë fazë, individi formon ide dhe i kontrollon. Faza e diskutimit është vazhdim i këtij procesi. Informatat e reja nga bashkënxënësit dhe burimet tjera i ndihmojnë nxënësit që t'i analizojë idetë e tij. Përfundimisht, faza e aplikimit u ofron nxënësve përvoja të reja për verifikimin e ideve të tyre për fenomenet natyrore konkrete.

2. Teoria sociologjike e orientuar

Ithtarë e qasjes sociologjike, në arsimim e shohin nxënësin si qendër e kurikulimit. Ata besojnë se përmbajtja e lëndës mësimore duhet të jetë relevante për nxënësin. Më tutje, ata besojnë se të mësuarit nga brenda është i motivuar nga përvojat personale të rrekjes me problemin.

Xhon Dui (John Dewey (1953)), promotori udhëheqës i teorisë së orientuar sociologjike, mendonte se shkollat nuk ofronin në sasi të mjaftueshme “përvoja reale të të mësuarit”. Përkundrazi, ai e shikonte arsimin formal si proces të prezentimit të fakteve që pritet nxënësit ti mbajnë mend. Dui vazhdimisht e potenconte hendekun mes përvojave shkollore dhe atyreve jashtë shkollës. Pa kurfarë lidhjesh mes këtyre dyjave, ai mendonte se të mësuarit e vërtetë dhe rritja janë të pamundësishme.

Cikli i të mësuarit është strategji e përshtatjes së mësimdhënies e cila u mundëson arsimtarëve të zgjedhin me kujdes llojet e përvojave të të mësuarit për të cilat mendojnë se janë të rëndësishme për nxënësit e tyre. Fazat e hulumtimit dhe aplikimit janë në pajtueshmëri me parashikimet e Duit për përvojat e vërteta të të mësuarit. Faza e aplikimit mund ta tejkalojë hendekun mes përvojave shkollore dhe atyreve jashtë shkollës, duke u ofruar mundësi nxënësve që informatat e marrura në fazat e hulumtimit dhe

diskutimit ti aplikojnë në situata në jetën e përditshme. Kështu, shembull, leksioni sipas ciklit të të mësuarit e dhënë në këtë pjesë, lidhur me shfrytëzimin e skemës së Panetit, u ofron nxënësve përvoja për zgjidhje të problemeve dhe mundësi për aplikimin e informatave të fituara nga ato përvoja në diçka me të cilën të gjithë individët hasen gjatë tërë jetës – cilësitë e trashëgueshme.

3. Teoritë e orientuara neurologjike

Teoritë e orientuara neurologjike përqipen të kuptojnë se si pjesët e ndryshme të trurit e ndihmojnë të mësuarit. Në këtë fushë, kujdes i veçantë i kushtohet specializimit hemisferial. Literatura ekzistuese e përkrahë vërtetimin se hemisfera e majtë dhe e djathtë e trurit kryejnë funksione të ndryshme. Shembull, hemisfera e majtë zhvillon raporte krahasuese, lineare, kohore dhe funksione sekuenciale, kurse hemisfera e djathtë është kryesisht e preokupuar me skema hapsinore, holistike, fotografi dhe skema joverbale mendore. Megjithatë, duket se të dy hemisferat funksionojnë bashku për të krijuar aktivitetet të integruar mental.

Përkrahësit e teorive të integruara neurologjike besojnë se mësimdhënia në klasë duhet të mbështetet në të dy hemisferat e trurit. Ata thonë se pjesa më e madhe e mësimdhënies në klasë është e fokusuar në hemisferën e majtë, duke theksuar shkathtësitë siç janë të lexuarit, të shkruarit dhe llogaritjet aritmetike. Këta përkrahës mendojnë se në rast se mësimdhënia në klasë përmbanë kombinime të aktiviteteve të hemisferës së majtë dhe djathtë (shembull; mendimi kreativ, vizatimi, aktivitete interdisciplinare, etj), nxënësve do tu jepej mundësi që në tërësi ti zhvillojnë kapacitetin e tyre mental.

Cikli i të mësuarit është kompatibil me teoritë e orientuara neurologjike të të mësuarit. Hulumtimi i realizuar nga Krafti (Kraft (1976)) tregon se kur ndonjë personi i jepet ndonjë detyrë, hemisfera e djathtë patjetër "provon" dhe absorbon të gjitha informatat joverbale lidhur me detyrën, parase që hemisfera e majtë ti aplikojë të gjitha procedurat lineare dhe logjike të organizimit të informatave. Kjo tregon se kur nxënësve u jepen aktivitete që përmbajnë materiale ose objekte, ata patjetër do ta shfrytëzojnë edhe hemisferën e majtë edhe hemisferën e djathtë që ti përpunojnë informatat që i marrin nga ato aktivitete. Për shkak të natyrës së orientimit kah aktivitetet e fazave të hulumtimit dhe aplikimit të nocioneve, duket i arsyeshëm konkludimi se këto pjesë të ciklit të të mësuarit përkrahin shfrytëzimin e të dy hemisferave të trurit.

4. Teoria e inteligjencës multiple

Hauard Gardner (Howard Gardner (1991)) teoretizon se të gjithë njerëzit kanë inteligjenca multiple. Ai thotë se të gjithë individët kanë aftësi për njohjen e botës përreth me ndihmën e gjuhës, analizës matematiko-logjike, prezentimit hapsiror, përfytyrimin muzikal, inteligjencës truporo-kinestetike (shfrytëzimi i trupit për zgjidhjen e problemeve ose për të krijuar diçka), të kuptuarit e individëve tjerë dhe vetvetes, si dhe të kuptuarit e natyrës. Më tutje, ai beson se është shumë e rëndësishme që shkollat t'u mundësojnë nxënësve që ti shfrytëzojnë këto lloje të inteligjencave në kontekst të kurikulimit shkollor.

Cikli i të mësuarit është mjaft i përshtatshëm për tu mundësuar arsimtarëve që të zhvillojnë leksione të cilat janë kompatible me teorinë e inteligjencës multiple të Gardnerit. Varësisht nga ajo se si individit e strukturon secilën fazë nga cikli i të mësuarit, nxënë-

sit mund të përjetojnë përvoja që e përforcojnë secilin prej talenteve të identifikuar prej Gardnerit. Faza e angazhimit është dizajnuar me qëllim që tu ndihmojë nxënësve për ti kuptuar idetë e tyre personale dhe ato të bashkënxënësve të tyre, gjë që, nga ana tjetër, do tu ndihmojnë që të kuptojnë vetveten dhe të tjerët. Llojet e përvojave dhe strategjive që shfrytëzohen në fazat e hulumtimit dhe aplikimit, mund të formulohen në mënyrë që ti ndihmojnë nxënësve të zhvillojnë analiza matematiko-logjike, prezentim hapsiror, përfytyrim muzikor dhe inteligjencë truporo-kinestetike. Mëtej, interaksioni social i cili është komponentë e të katër fazave, mund të jetë mekanizëm që u ndihmon nxënësve që ta përforcojnë zhvillimin e gjuhës.

TË MËSUARIT KOOPERATIV, SHOQËRIA SHKENCORO-TEKNIKE (SHSHT) DHE CIKLI I TË MËSUARIT

Cikli i të mësuarit është kompatibel edhe me dy ternde aktuale në arsimin e shkencave të natyrës – të mësuarit kooperativ dhe Shoqëria-shkencoro-teknologjike (STS). Dy pjesët vijuese japin përshkrim të shkurtër të këtyre trendeve dhe diskutojnë se si ato mund të kyçen në ciklin e të mësuarit.

Të mësuarit kooperativ

Në decenien e fundit, të mësuarit kooperativ u paraqit si një trend i rëndësishëm në arsimin e shkencave të natyrës. Fokusi kryesor i të mësuarit kooperativ është ofrimi i përvojave përmes të cilave nxënësit ndihmohen gjat të mësuarit. Qëllimi arrihet me grupimin e nxënësve në palë ose grupe të vogla, gjat së cilës kërkohet nga ata të punonë së bashku për përmbushjen e ndonjë qëllimi të përbashkët (p.sh., të mësuarit e informates konkrete, zotërim me ndonjë shkathtësi ose zgjidhje të ndonjë problemi).

Disa studime rrëfejnë se të mësuarit kooperativ mund ta përforcojë suksesin (Johnson & Johnson, 1982). Shembull, këto studime tregojnë se nxënësit që punojnë në grupe të vogla cooperative (2-4 nxënës) përpunojnë më shumë material, më tepër janë të motivuar të mësojnë dhe kanë qëndrim pozitiv për mësimin sesa nxënësit që punojnë individualisht ose kompetitivisht. Mëtej, duket se të mësuarit kooperativ ka ndikim pozitiv edhe në vetërespektimin e nxënësit.

Leksionet sipas ciklit të të mësuarit mund të strukturohen për përvoja cooperative të mësimit. Nxënësve mund tu shtrohen detyra të orientuara kah aktivitetet e paramenduara për të mësuarit kooperativ, qoftë në faze të hulumtimit ose në fazën e aplikimit. Edhe më tepër, faza e diskutimit mund të strukturohet në mënyrë që të promovojë interaksion në grupe të vogla lidhur me të dhënat e mbledhura në fazën e hulumtimit. Që ta shihni se sit ë mësuarit kooperativ mund të kyçet në leksionet sipas ciklit të të mësuarit, shikojeni leksionin që ka të bëjë me truallin, dhëni në pjesën 4.

Shoqëria shkencoro – teknologjike (Science Technological Society)

Shoqëria shkencoro-teknologjike ose STS, i përket interaksionit i cili paraqitet mes shkencës, aplikimit të saj dhe shoqërisë. Shumica e arsimtarëve të shkencave natyrore besojnë se për funksionimin efektiv të nxënësve në shoqëri, atyre patjetër duhet t'u ipen mundësi që të hulumtojnë, diskutojnë dhe përvetësojnë tema nga shoqëria shkencoro-teknologjike, sikurse që është ndotja me hedhurina helmuese, ndotja industriale, shfrytëzimi i resurseve të tikës dhe shfrytëzimi i resurseve energjetike. Si rezultat i kësaj, edukatorët në fushën e shkencave të natyrës propozojnë që këto tema të marrin pjesë me 5-10% në kurikulumin e shkencave të natyrës në arsimin e mesëm.

STS mund të kyçet në mësimet sipas ciklit të mësimit. Në fazat e hulumtimit dhe aplikimit, nxënësit mund të luajnë role aktive në situata specifike të cilat janë zhvilluar si rezultat i pyetjeve në fushën e shoqërisë shkencorë-teknologjike, mundet në mënyrë kritike ta analizojnë problemin, ose mund të zhvillojnë plan akcional për zgjidhje problemeve aktuale nga fusha e STS. Gjatë kohës së fazës së diskutimit, gjatë bisedave në tema konkrete nga shkencat e natyrës, lehtë mund të futen probleme nga STS.

Demonstrimi i asaj se si mund të kyçet STS në leksionet sipas ciklit të të mësuarit është dhënë në mësimin lidhur me truallin (tokën). Gjatë këtij mësimi janë angazhuar në të ushtruarit e luajtjes së roleve me qëllim që t'i shqyrtojnë zgjidhjet e mundshme në problemin konkret lidhur me ambientin jetësor.

CIKLI I TË MËSUARIT DHE MËSIMI AKTIV

Për realizim të suksesshëm për orë mësimore sipas ciklit të të mësuarit në principet për aktivitet të mësimit-interaktiv. Me një fjale komponentet të mësimit aktiv janë të orientuar nga nxënësi apo nga mendimi kreativ, krijues i tij, onorganizim i punës hulumtuese, si dhe këmbim mendimesh, diskutime dhe aplikim modleve aktive të problemeve - zhvillimore.

Në thëlb për tu realizuar cikli i mësimit, realizatorët e përmbajtjeve mësimore duhet të kyçin: *aktivitetet, interakcion, integrim, hulumtim, individualizëm, diferencim, socializëm, motivim, punë ekipore*. Të përkujtohem në këto veçori:

□ **Aktiviteteti:**

Në çdo moment në procesin edukativo-arsimor nxënësit të jenë pjesëmarrës-aktiv, subjekt. Me se shumti mësohet nga përvoja personale dhe aktiviteti konkret.

□ **Interakcioni:**

Raport partneri në mësim: arsimtar-nxënës. Akcion i përcjellur me reaktion dhe e kundërta. Interakcioni rezulton me përparim në dituritë.

□ **Integrimi:**

Angazhim i tërësishëm i nxënësit në zgjidhjen e problemit, vështron lidhje të reja, marëdhënie, shfrytëzon njohuri dhe aktivitet nga grupi naryror i lëndëve mësimore, por edhe nga shkencat dhe disiplinat tjera shkencore.

□ **Hulumtimi:**

Përsosje nga burimet dhe dituritë, krijimi i situatave problematike, punë vetijake e nxënësit intuitive, tandem, grupe. Zbulim dhe zbulim dhe kuptim të nocioneve të reja, nocione të problemeve në përpuethshmëri me temën nëpërmjet më shumë etapave.

□ **Individualiteti dhe diferencimi:**

Respektimi i individualitetit të secilit nxënës zhvillimin e tij optimal dhe të përgjithshëm. Punë individuale dhe në grupe.

Ekgzekutim të aktiviteteve diferenciale në nivele të ndryshme. Sipas paraditutive, shkathtësive, intereseve, marëdhëniet ndërjet veti, bashkëpunim etj.

□ **Socializimi:**

Ka më shumë mundësi për interakcion social në mes nxënësve, apo shoqërimit dhe njohjes me nxënësit në grup apo në klasë. Bashkëpunim i përbashkët, kooperim, mundësi për mësim komperativ të ndihmon apo të kërkon ndihmë ta rishqyrton diturinë e vet, kuptimin e vet, qëndrimet etj.

□ **Motivim:**

Arrihet me paralajmërimin e qëllimit në formë të problemit, e cila përjeton si detyrë të besueshme me situatat e cila duhet të zgjidhen. Motivimi, nëpërmjete prob-

lemit të përshtatshëm mësimor duhet të jetë reale bindëse, e matur, të jetë sipas mundësive të nxënësve, të motivon dukuri vetijake, përvojë, aktivizim, gjetje të zgjidhjes, zbatim të metodave, mjeteve, veprime, aftësi, nxjerrjen e përfundimeve dhe vlerë praktike. Motivimi nëpërmjet përdorimit të pasqyimit simulativ të lavdateve, frymëzimeve, garave, përkrahje etj.

□ **Puna ekipore:**

Interesat e përbashkëta të nxënësit dhe arsimtarit, realizimi i ideve kolektive, parashikimet, planifikimi, kreativiteti, ndarja e përbashkët dhe e hapur e informatave, përpunim dhe shkëmbim idesh, realizim përvojash, respektim i punës së të tjerëve, ndarja e punës, komunikimi efikas, vlerësimi i gabimeve, vlerësimi i përparimit, ndarja e përgjegjesisë personale etj.

□ **Organizim të brendshëm:**

Të ri dhe të ndryshëm dhe rënditje e hapsirës së klasës, bankat e klases, karriget etj. Pozicion të njejtë për çdo nxënës dhe ballafaqime me të tjerët. Rol të ri dhe më të ndryshëm të arsimtari në klasë, arsimtari si udhëheqës, mentor, partner, ndëgjues, refer etj.

SHKATHTESITË E TË MENDUARIT DHE AKTIVITETE TË NXËNËSIT NË CIKLIN E TË MËSUARIT

Arritja e aftësive për të përdorur shkathtësi të ndryshme për të mënduar kërkon përdorim efikas të aktiviteteve të cilat nuk janë përdorur vetëm te grupi i lëndëve natyrore, por janë pjesë integrale të aktiviteteve të përditshme të jetës sonë.

Në ciklin e mëimit përdoren shkathtësi integrale themelore. Të parat janë shprehje më të thjeshta, të dytat janë shkathtësi për mëndim më të kompleksuar. Sidoqoftë edhe njërat edhe të tjerat janë shkathtësi e të menduarit për të cilat duhet të kemi kujdes gjatë planifikimit të orës mësimore, pasi që përmbajtjet mesimore nga gjeografia janë mjete të përshtatshme për hyrje dhe zhvillim të shkathtësive në proces. Ashtu që në secilën prej fazave arsimtarët nga gjeografia duhet të sjellin modele për përsosje nëpërmjet të cilës mund të planifikojnë aktivitete të cilat do t'ju ofrojnë nxënësve mundësi për përdorim të një apo më tepër shkathtësive në procesin e realizimit të mësimin nga gjeografia nxënësve ju ipet mundësi të jenë më të suksesshëm më kreativ, efikas, në përvetësimin e nocioneve.

Tabela **SHKATHTËSITË E TË MENDUARIT**

SHKATHTËSITË THEMELORE	SHKATHTËSI INTEGRUESE
<p>Vështrimi - kjo shkathtësi ka të bëjë me mbledhjen e informacioneve me ndihmen e përdorimit të një apo më tepër shqisave siç janë: (shikimit, ndëgjimit, nuhatjes, prekjës). Atje ku përvoja direkte senzore nuk është adekuadë për zbatimin e nevojshëm të përcjelljes, përdoren metoda indirekte. P. sh. me ndihmën e përdorimit të instrumenteve si mikroskopi, termometri, peshorja, sonda kompjuterike, shkencetarët mundën që t'i përforcojnë organet për përcjellje më precize.</p> <p>Supozimet - kjo shkathtësi është ide e bazuar në përcjellje apo seri përcjelljesh. Vënia e supozimeve kërkon evoluim dhe gjykim bazuar në përvojat e mëparshme.</p> <p>Parashikimet - ky komunikim për rezultat të pritur bazohet në njohuritë e mëparshme. Reljabiliteti për supozimin varet nga preciziteti i përcjelljeve të mëparshme dhe natyra e ngjarjes e cila parashikohet.</p> <p>Klasifikimi - grupimi i lëndeve apo ngjarjeve sipas ndonjë skeme të vërtetuar. Skemat për klasifikim bazohen në ngjajshmëri dhe dallime të karakteristikave të zgjedhura të cilat mund të përcjellen.</p> <p>Matje - matja e karakteristikave të lëndeve apo ngjarjeve mund të arrihet më një krahasim direkt apo më krahasim indirekt më njësi matëse të cilat për nevojat e komunikimit mund të jenë standarde.</p> <p>Komunikimi - kjo është ndërrim informacionesh të fjalës me anë të gojës apo të shkruar apo nëpërmjet rrugës së ndonjë paraqitjeje grafike.</p>	<p>Komentimi i të dhenave - komentimi i të dhenave kërkon zbatim të shkathtesive tjera, siç janë supozimet, parashikimet, klasifikimet dhe komunikimi. Nëpërmjet këtij procesi vërtetohet dobia e të dhënave gjatë zgjidhjes së problemeve dhe përgjigjet në pyetjet.</p> <p>Formimi i pyetjeve dhe hipotezave - Pyetjet formohen në bazë të përcjelljeve të bëra. Normalisht pyetjeve bëhen më tëntim që të vlerësohet ndonjë situatë apo ngjarje. Formimi i hipotezave drejtpërdrejtë nvarët nga pyetjet, përcjelljet, supozimeve, parashikimeve të cilat mund të bien deri te përpunimi i dëshmise e cila mund të testohet, provohet.</p> <p>Definimi operativ - bëhet me qëllim të thjeshtësimit të komunikimit lidhur me fenomenin i cili hulumtohet. Ata janë bazuar në karakteristikat e dukshme të fenomeneve dhe operacioneve të cilat duhet realizuar.</p> <p>Eksperimentimi - ky është proces i dizajnit të procedurave, mbledhjen e të dhënave të përshtatshme për qëllimin të testimit të ndonjë hipotezë të caktuar.</p> <p>Formimi i modeleve - modelet se fizike ashtu edhe mentale, prpunohen mbi baza të hipotezës së pranueshme apo hipoteza të cilat duhet të testohen. Modelet përdoren për të përshkruar edhe sqaruar lidhshmërinë në mes ideve. Në shumë raste modeli nënkupton hipotez të re: nëse testimi i këtyre hipotezave rezulton me informacione të reja, modeli ndryshon me qëllim që t'i kyçë të dhenat e reja.</p>

Lexo tekstin e shkurtër dhe diskuto fazat e orës sipas ciklit të të mësuarit

Lexo tekstin për orë të planifikuar nga gjeografia, sipas katër fazave nga cikli i të mësuarit. Në nivel të grupit diskuto rreth fazave në orë, dhe mundohuni të bëni plotësime, shikime të reja, ose përgatitni planifikim tjetër për orën nga gjeografia, sipas cilkeve të mësimit.

Vërejtjet e juaja shënoni në letër plakati. Kur të jeni të gatshëm caktoni prezentues para grupeve tjera.

Tema mësi: PLANETA TOKË**Përmbajtja mësimore: Llojet e shkëmbinjve****Mënyra e punës:**

Puna në grupe

Materiali i duhur:

- më shumë lloje të ndryshme të shkëmbinjve, me ngjyrë të të ndryshme, madhësi, fortësi dhe peshë;
- disa llupa dore;
- mikroskop nga shkolla;
- blok për skicim;
- më shumë lapsa dhe goma;
- fotografi të llojeve të nryshme të shkëmbinjve;
- vizatime si janë krijuar shkëmbinjte;
- tekst për shkëmbinjte;
- disa mapa të njehta të teritorit;
- tekst të vendzbulimeve;
- tekst për ate se cili shkëmb për se nevojitet;
- atlas nga gjeografia fizike
- fjalorë vizuel të tokës;

Angazhim hyrës:

- Tregojuni nxënësve disa lloje të shkëmbinjve.

Pyetje: - Ç'ka mbaj në duar?

- Ç'ka mendoni si janë krijuar këto shkëmbinj?

- Nëse dinë diçka për shkëmbinjte, kërkoni nga nxënësit ta shfrytëzojnë njohurinë e tyre dhe të ju japin përshkrim nga ndonjë shkëmb, apo tju tregojnë diçka mbi krijimin e shkëmbit.

- Pas përgjegjeve të nxënësve, tregojuni se në këtë orë, dote bëni një hulumtim.
- Për ate se si janë krijuar llojet e këtyre shkëmbijë dhe ç'faraë llojë shkëmbinjsh egzistojnë në sipërfaqe të Tokës dhe në mbrendësinë e sajë.

Hulumtimi:

Ndani nxënësit në grupe nga katër. Kërkoni nga çdo grup t'i punojë detyrat ardhshme:

1. Secilit grup jepni nga dy, tre lloje të shkëmbinjve.
2. S'ëpari, tregonju nxënësve se seilin shkëmb duhet ta emërtojnë sipas zgjedhjes së vet, me emër, numër, apo shkronjë.
3. E dyta, tregojuni se duhet mirë ti shikojnë shkëmbinjët, ta masin peshën e tyre, ta analizojnë fortësinë dhe ngjyrën, ta shikojnë përbërjen e shkëmbit me llupë apo mikroskop.
4. Pas kësaj, tregojuni se të gjitha shënimet për shkëmbinjët duhet ti shënojnë në fletoret e tyre dhe të mundohen të vizatojnë - pamjen dhe përbërjen e shkëmbinjve.
5. Pas këtyre veprimeve, nxënësit le të mundohen lehtë tju mëshojnë shkëmbinjve njëres me tjetrën dhe pastaj le ti vërejnë karakteristikat - ndryshimet të shkëmbijve nëse i kanë (p.sh. ;thehet, imtësohet, ndriçon, nuk ka kurfarë ndryshimi etj.).
6. Përsëri pas çdo të mëshuari, shkëmb me shkëmb, nxënësit në fletoret e tyre ti shënojnë karakteristikat të ndryshimeve të pamjes të çdo shkëmbi (nëse ka ndryshime, nëse nuk ka shënojnë nuk *vërehen ndryshime te shkëmbijë*).

Diskutimi:

Nxënësit le t'i diskutojnë shënimet e e tyre dhe vizatimet në nivel të grupit.

Shënoni nocionet: **magmatik**, **sedimentues** dhe **shkëmb metamorf**, nocionet graniti, glina, laporci etj. Përdorni nocionet: **mineralet**, **xehet**.

Nxënësve sqarojuni karakteristikat e çdo njëres të këtyre nocioneve.

Nxënësit në bazë të tekstit fotografik, vizatimeve, që ju jep arsimtari i identifikojnë emrat e shkëmbinjve të llojeve të ndryshëm. Arsimtari iu jep sqarime të shkurta për karakteristikat e llojeve të ndryshme të shkëmbinjve, nxënësit në bazë të tekstit, fotografive, vizatimeve bëjnë diskutim të shkurtë.

Sqarojuni nxënësve pse janë të rëndësishme llojet e ndryshme të shkëmbijve, respektivisht përdorimi i ndryshëm i tyre. Diskutoni pse llojet e ndryshme të shkëmbinjve mund të shkaktojnë probleme serioze të ngjyrës së tokës (shembull erozioni) dhe pamja e llojeve të ndryshme të përbërjes.

Kërkoni nga nxënësit të lexojnë material të përshtatshëm për atë se si llojet e ndryshme të shkëmbinjve ndikojnë në pamje dhe ndërtimin e tokës.

Zbatimi:

Ndani nxënësit në grupe nga kater. Kerkoni nga çdo grup te zgjedhe: **moderator, mbledhes te informacioneve, këshilltar, prezentues**. (Moderatori e organizongrupin dhe i përcjell aktivitetet e grupit. Mbledhësi i informatave shënon informata ose ide të cilat i gjeneron grupi. Prezentuesi dhe këshilltari teknik do të jenë përgjegjës rreth prezentimit të zbulimeve të grupit dhe këshillat deri te tërë klasa.)

Siguroni hartë në të cilën janë futur vendzbulimet të llojeve të ndryshme të shkëmbinjëve. Poashtu siguroni prodhime të ndryshme nga shkëmbinjë të ndryshëm. Jepni tekst të shkurtër në lidhje me hartën, vendzbulimet, fabrikat të cilat prodhojnë lloje të ndryshme të prodhimeve nga shkëmbinj të ndryshëm.

Detyra e çdo grupi është që t'i vertetojë ato vende ku prodhohet dhe të shënojnë disa veti të prodhimeve si dhe përdorimin e tyre. Çdo grup duhet të përdore librin, pastaj njohurinë e mëparshme dhe të bën klasifikim se cili shkëmb ku gjendet dhe për çfarë përdoret. Në fund pritët që këshilltari dhe prezentuesi të ofrojnë sqarime për planin e propozuar.

Vërejtje: Nëse nxënësit vlerësojnë se për kompletimin e fazës 4-zbatim i janë të duhura informacione shtesë dhe kohë, atëherë e njejta mund që të realizohet gjatë orës tjetër. Për realizimin e kësaj ore mësimore mund të përdoret përmbledheje petrografike, të dhëna dhe fotografi të marrura nga literaturat, Interneti etj.

Tema mësimore: UJRAT NË TOKË

Përmbajtja mësimore: Gjendja agregate dhe qarkullimi rrethor i ujit

Qëllimet e përmbajtjes mësimore:

Nxënësit do të mund të:

- i përvetësojnë gjendjet agregate të ujit
- e përshkruajn qarkullimin rrethor të ujit
- kuptojnë se uji paraqet kusht për jetën në tokë
- e zbatojnë njohrinë e tyre për gjendjet agregate në tokë dhe qarkullimin rrethor të ujit, gjatë zgjidhjes së problemeve të lidhura me shfrytëzimin e ujit.

Lloji i punës:

Puna në grupe

Materialet e nevojshme:

- 1 enë të metalit
- më shumë copëza akulli
- 1 enë të plastikës apo qeramikës
- 1 shishe spërkatëse mbushur me ujë
- flomastera të paketuar
- vizatim për skicim
- më shumë lapsa dhe goma
- vizatim me qarkullim rrethor të ujit
- tekst për qarkullim rrethor të ujit
- atlas nga gjeografia fizike
- fjalor vizuel të tokës

PËRSHKRIM TË AKTIVITETEVE TË ARSIMTARIT DHE NXËNËSVE SIPAS CIKLIT TË TË MËSUARIT

Angazhim hyrës:

- Pyetje: - Uji, përveç i lëngët, në çfar gjendje tjetër mund ta hasim në natyrë?*
- Nëse din diçka për gjendjen agregate të ujit kërko nga nxënësit ta shfrytëzojnë përvojën e tyre dhe të ju japin një përshkrim të një gjendjje gregate.

- Pas përgjegjeve të nxënësve tregojuni se në këtë orë do të bëni një hulumtim për gjendjen agregate të ujit, për qarkullimin rrethor të ujit në natyrë dhe rëndësia e tyre.

Hulumtimi:

Ndani nxënësit në grupe nga katër. Kërko nga çdo grup ti punon detyrat që vijojnë:

1. Çdo grupi tregoni enën e metalit plot me akull mbi pjatë.
2. Së pari, tregoni nxënësve që duhet disa minuta ta shikojnë enen metalike dhe çdo ndryshim ta shënojnë në blloqet e tyre.
3. E dyta, tregojuni se duhet të shënojnë dhe kohën e ndryshimeve dhe të japin përshkrim të çdo ndryshimi.
4. Pas kësaj, tregojuni se të gjitha shënimet për gjendjen agregate të ujit ti shënojnë në blloqet e tyre.
5. Pas këtyre veprimeve, nxënësve sqarojuni për qarkullimin rrethor të ujit në natyrë dhe jepni vizatim të cilin duhet ta plotësojnë.

Diskutim:

Nxënësit le ti diskutojnë shikimet e tyre, shënimet dhe vizatimet në nivel të grupit. Shënoni konceptet: **gjendja e gaztë, lëngët, ngurtë e ujit, kondezimi, avull uji, avullim, retë, të rreshurat** (shiu, bora, breshëri), **ujra të ëmbël** (burime, lumenj liqene, ujra nëntokësorë), **ujra të kripur** (oqeane, detra), **qarkullimi rrethor i ujit natyrë**. Nxënësve sqarojuni karakteristikat të secilës nga këto nocione.

Nxënësit në bazë të tekstit, fotografish dhe vizatime të cilat ju jep arsimtari i indentifikojnë gjendjen agregate dhe qarkullimin rrethor të ujit dhe nxënësit në bazë të tekstit, fotografive dhe vizatimeve këmbëjnë diskutime të shkurta.

Sqarouni nxënësve pse janë të rëndësishme gjendjet agregate të ujit, dhe qarkullimimrrethor në natyrë. Diskutoni, pse përdorimi joracional i ujit mund të shkaktojë probleme serioze mbi jetën e gjallë (p.sh.: thatësia, ndotja dhe të ngjajshme), dhe mbi pamjen e tokës.

Kërkoni nga nxënësit të lexojnë material të përshtatshëm për gjendjen agregate, qarkullimin rrethor të ujit në natyrë dhe problet e ujit në botë.

Zbatimi:

Ndani nxënësit në grupe nga katër. Kerkoni nga çdo grup te zgjedhe: **moderator, mbledhes te informatave, këshilltar, prezentues**. (Moderatori e organizon grupin dhe i përcjell aktivitetet e grupit. Mbledhësi i informatave shënëon informata ose ide të cilat i gjeneron grupi. Prezentuesi dhe këshilltari teknik do të jenë përgjegjës rreth prezentimit të zbulimeve të grupit dhe këshillat deri te tërë klasa.)

Siguroni skemë-vizatim për qarkullimi rrethor i ujit në natyrë Në këtë skemë nxënësit në vendet e zbrazta duhet ti shënojnë nocionet e mëparshme të mësuara.

Jepuni tekst të shkurtër në lidhje me vizatimin. Detyra e çdo grupi është që në vendet e zbarazta ti venë nocionet e përshtatshme. Çdo grup duhet ta shfrytëzon tekstin, pastaj njohurinë e mëparshme dhe të bëjë indentifikimin se cili nocion ku duhet të shënohet. Në fund pritët që këshilltari dhe prezentuesi të japin sqarime për skemën-vizatimin e shënuar.

Vërejtje: Nëse nxënësit vlerësojnë se për kompletimin e fazës 4-zbatim i janë të duhura informacione shtesë dhe kohë, atëherë e njejtë mund që të realizohet gjatë orës tjetër

Tema 4

**PLANIFIKIMI,
DIZAJNIMI DHE VLERËSIMI
I ORËS MËSIMORE**

PLANIFIKIMI, DIZAJNIMI DHE VLERËSIMI I ORËS MËSIMORE

Njësia themelore kohore, në procesin mësimor është ora mësimore.

Njësia mësimore është periudha më e shkurtë për fillim me mësim, me çka nxënësit arinë diuri, shprehi, shkathtësi, e zhvillojnë të menduarit, vullnetin, mësojnë qëndrime dhe reaksione emotive etj.

Të planifikohet ora mësimoredhe të bëhen përgatitje për realizimin e tijë, do të thot, të mendohet për te dhe të përgjigjet në më shumë pyetje për te. Që arsimtari të përgatitë plan të mirë dhe përgatitje për realizimin e orës mësimore, së pari nga ai pritet:

- *t'i harmonizoj qëllimet e dhëna dhe kushtet materialo - teknike, organizimin dhe koordinim i tyre.*
- *ti definojnë dhe zhvillojnë qëllimet, detyrat, diturit arsimore dhe aftësi funksionale.*
- *të sigurojë lidhshmëri maksimale të qëllimeve, përmbajtjes, mjeteve mësimore, formave sociologjike të detyrës mësimore dhe metodat mësimore.*
- *të sigurojë përmbajtje artikulluese, koncept të orës dhe fazat e saj.*
- *të siguron lidhshmëri të brendëshme ndërmjet lëndëve apo korelacion dhe integrim.*
- *të sigurojë bashkpunim maksimal me nxënësit si dhe bashkpunim në mes nxënësve, respektivisht praktikim të interakcionit.*
- *të sigurojë aktivitet maksimal dhe motivacion të nxënësve.*
- *të mundësoj ë aktivitet të të menduarit, formimi i pamjes shkencore për botën dhe orijentimimi nxënësve nga vlerat e caktuara, fotografi më të qarta për vetveten, dituri fleksibile dhe të përhershme, punë me dëshirë, bashkpunim në mes veti, zhvillimi i aftësive të veta, dituri praktike të përdorshme dhe të ngjajshme.*
- *të sigurojë mjete dhe veprime për kontrollim in e rezultateve të arritura.*

Struktura e planifikimi / përgatitja për orë mësimore i përfshinë këto elemente:

- Qëllime konkrete të orës, njohuri dhe shkathtësi
- Drejtime didaktike, aktivitete, motivacion, dhe zbatim
- Dinamika e realizimit të përmbajtjes mësimore, fazat - etapat e orës
- Përgatitje për kushte të punës dhe mjete mësimore për realizimin e orës mësimore
- Format, metodat dhe aspekte të tjera të teknologjisë arsimore
- Organizim dhe aktivitete të arsimtarit dhe nxënësve

- Bashkëpunim dhe kyçje të subjekteve tjera
- Integrim dhe korelacion (lidhshmëri ndërmjet lëndëve)
- Mjete, veprime dhe instrumente për përcjellje, kontrollim dhe vlerësim i të ariturave të nxënësve
- Konstatim dhe vërejtje nga ora e realizuar.

PROPOZIM I MODELIT PËR PREGADITJE DITORE PËR ORË

Tema:

Lloj i orës:

Qëllime konkrete:

Koncepte të cilat duhet të përvetësohen:

Shkathtësi dhe paradituri të nevojshme:

Material i nevojshëm:

Korelacion (lidhshmëri ndërmjet lëndëve):

Pregaditje e mëparshme:

Organizim i orës:

Faza e orës	Përshkrim i aktiviteteve të planifikuara të arsimtarit dhe nxënësit
Angazhim hyrës	
Hulumtim	
Diskutim	
Aplikim	

Mjete dhe veprime për notim:

Konstatime dhe vërejtje për orën e realizuar:

PROPOZIMET PËR PLANIFIKIM HAP-PAS-HAPI

- Hapi 1** - Identifikoni nocionin ose nocionet të cilat dëshironi t'i prezentoni në leksion.
- Hapi 2** - Bëni kontrollë të informatave të nevojshme lidhur me konceptin ose nocionet të cilët i keni zgjedhur. Keni kujdes të mos përpiqeni të arrini shumë! Më së miri të fokusoheni vetëm në një ose më shumë terme të lidhur. Është sprovë e madhe të shtrohen më shumë nocione (terme) të reja dhe të kombinohen në një leksion. Që nxënësit mentalisht t'i përvetësojnë të gjitha informatat, do të ishte shumë më adekuate që ndonjëherë të sajohen leksione të veçanta; që do t'u përkasin nocioneve të veçantë më të komplikuar. Kjo do t'u sigurojë nxënësve më shumë kohë për të bërë lidhjet e domosdoshme mentale që t'i kuptojnë raportet mes këtyre nocioneve.
- Hapi 3** - Parashtroni qëllimin ose qëllimet konkrete për secilin leksion. Këto qëllime do t'u ndihmojnë të fokusoheni në idetë kryesore të cilat janë prezentuar në leksionin. Edhe pse rezultatet e nxënësve më së shpeshti nuk janë të përkufizuar në atë që është theksuar në qëllimet, këto qëllime të paraqitura mund të ndihmijnë në vlerësimin e efektshmërisë të secilit leksion.
- Hapi 4** - Identifikoni ecuritë dhe aktivitetet përkatëse për secilën fazë të leksionit. Strategji dhe aktivitete të caktuara të të mësuarit tregojnë rezultate më të mira në faza të caktuara nga cikli i të mësuarit. Më poshtë është cekur lista e pjesërishme e strategjive adekuate të mësimdhënies për secilën fazë.
- Hapi 5** - Pasiqë të jetë planifikuar leksioni, rikthehuni qëllimeve të cilat i keni parashtruar për atë leksion. Me rëndësi është që idetë kryesore të jenë të përherëshme në secilën prej fazave.

SHEMBUJ TË ECURIVE DHE FORMA TË MËSIMDHËNIES PËR SECILËN FAZË

ANGAZHIMI HYRËS

- Parashtroni pyetje nxënësve të cilat i përkasin nocionit konkret (shembull, leksioni lidhur me ndryshimet fizike, tregoni një copë letre dhe kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë pamjen e saj. Pastaj, mblidheni në grup në formë topi dhe kërkoni që nxënësit ta përshkruajnë pamjen e saj. Pyetni nxënësit: për çka dallohet letra në të dy rastet? Cilat janë ngjashmëritë?)
- Kërkoni nga nxënësit të bëjnë parashikime lidhur me nocionin e zgjedhur (shembull, leksionin për gravitacionin, tregoni dy objekte me masë të ndryshme në distance të njejtë nga toka. Pyetni: vallë këto dy objekte do ta prekin token në kohë të njejtë? Ose, njëri do të arrijë para tjetrit?)
- Të shkruarit e shënimeve- kërkoni nga nxënësit të shkruajnë në një faqe të kartelës (3x5) atë që e dinë për temën kryesore ose temat të cilat i përfshinë leksioni. Këto kartela do të mund të përdoren në fund të leksionit që të vlerësohet se çfarë ndryshimesh kanë ndodhur në të kuptuarit e nxënësve për idetë kryesore të leksionit.
- Brainstorming (stuhi ideshë – kërkoni nga nxënësit të trgojnë se çka dinë për përmbajtjen kryesore/temën e prezentuar në leksion.
- Bërja e hartës me nocione - nxënësit bëjnë hartë për idetë kryesore të leksionit (Novak J. D. and Gowin, D. B. 1984. Learning how to learn. NY: Cambridge University Press.)

HULUMTIMI

- Përvojat konkrete që ikyçin nxënësit në aktivitete për të cilën gjë nevojitet angazhim fizik dhe mendor. Këto aktivitete mund të përmbajnë përvoja kooperative të mësimi (shiko Johnson, D. W. , Johnson, R. T. , Johnson, E. and Holubec, P. R. 1984. Circles of Learning: Cooperation in the Classroom. Alexandria, VA: Association for Supervision and Curriculum Development.)
- Prezentimi i ngjarjeve të papritura (shih Liem, T. 1987. Invitations to Science Inquiry (2nd ed.). Chino Hills, CA: Science Inquiry Enterprises.)
- Simulime kompjutorike ose video prezente interaktive që i kyçin nxënësit në zgjidhjen e problemeve.

DISKUTIMI

- Prezentimi i informatave që i kanë mbledhur nxënësit gjatë fazës së hulumtimit.
- Diskutimi i udhëhequr nga arsimtari që i përket idesë kryesore në leksion.
- Demonstrimet e arsimtarit lidhur me idetë kryesore në leksion.
- Materialet, siç janë librat, video incizimet, video disqet CD romet. Mund të shfrytëzohen si burim informatash lidhur me leksionin.

APLIKIMI

- Përvojat konkrete të përfshirjes së nxënësve në aktivitete për të cilën gjë duhet angazhim fizik dhe mendor. Këto aktivitete mund të përmbajnë përvoja kooperative të mësimit
- Simulime kompjutorike ose video prezentime interaktive që i kyçin nxënësit në zgjidhjen e problemeve.
- Simulime që i kyçin nxënësit në sjelljen e përfundimeve
- Harta e nocioneve – nxënësit tregojnë të kuptuarit e tyre për idetë kryesore të leksionit duke konstruktuar harta të nocioneve.

Përgatit dhe prezento planifikimin e orës mësimore sipas ciklit të të mësuarit

Përgatitni plan ditor për orë mësimore nga gjeografia.

Shfrytëzoni programet arsimore nga gjeografia, libra dhe literaturë tjetër ndihmëse.

Fillimisht punoni individualisht, pastaj mendimet e juaja shkëmbeni me grupin. Orën e planifikuar shënojeni në letër pllakati-flip.

Përcaktoni individin i cili do ta prezentojë para grupeve tjera.

VLERËSIMI I PLANIFIKIMIN TË LEKSIONEVE TUAJA

Kjo llistë ju është ofruar që t'ju ndihmojë në planifikimin e njësive tuaja para se t'i përdorni me nxënësit tuaj. Shfrytëzojeni për të vërtetuar se vallë duhet ndryshuar disa komponenta konkrete të leksionit tuaj. Për arsyen se pjesa për **planifikimin para leksionit** nuk është pjesë e vetë leksionit, është përmendur si kategori e veçantë.

Lista kontrolli (çek-lista) të leksioneve të përgatitura sipas ciklit të të mësuarit

PLANIFIKIMI PARA LEKSIONIT		
	PO	JO
<input type="checkbox"/> Janë të identifikuar nocionet dhe shkathtësitë që do të mësohen.	_____	_____
<input type="checkbox"/> Ekzistojnë informata të mjaftueshme paraprake për atë Se si duhet planifikuar leksioni	_____	_____
<input type="checkbox"/> Qëllimet janë qartë të theksuara.	_____	_____
ANALIZA E LEKSIONIT		
	PO	JO
Angazhimi hyrës:		
<input type="checkbox"/> Shfrytëzohet ecuria për vlerësimin e njohurive apriori të nxënësve.	_____	_____
Hulumtimi:		
<input type="checkbox"/> Kjo fazë përmbanë përvoja konkrete që i kërkon nxënësit në aktivitete për të cilat është i nevojshëm angazhimi fizik dhe mendor.	_____	_____
<input type="checkbox"/> Është siguruar kohë e mjaftueshme për kryerjen e aktiviteteve	_____	_____
Diskutimi:		
<input type="checkbox"/> Nocioni ose termi adekuat është sjellur si rezultat i fazës së hulumtimit.	_____	_____
<input type="checkbox"/> Ndodhë interaksioni social mes nxënësve, si dhe mes arsimtarit dhe nxënësve	_____	_____
Aplikimi:		
<input type="checkbox"/> Nxënësit e përdorin nocionin në situatë të re.	_____	_____
<input type="checkbox"/> Shfrytëzohen aktivitete ose ecuri adekuate për aplikimin e nocionit (eti)	_____	_____
<input type="checkbox"/> Ka kohë të mjaftueshme për kryerjen e aktiviteteve.	_____	_____
<input type="checkbox"/> Vlerësimi i leksionit përkon me qëllimet e shfaqura.	_____	_____

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË LEKSIONEVE TUAJA

Lista vijuese është dizajnuar të ofrojë mekanizëm për vetë-vlerësim pasiqë leksionet të jenë përpunuar me nxënësit tuaj. Për leksionet e para të cilat do t'i dizajnoni. Ju këshillojmë ta incizoni realizimin e leksioneve dhe ta shfrytëzoni këtë listë analitike për vlerësimin e tyre.

LISTA PËR VLERËSIM ANALITIK

segment nga leksioni	kategoritë të cilat vlerësohen		
	Kërkon përmirësim	kuptueshmëri	shëmbëlltyrë
Angazhimi hyrës	<p>Planifikim i pamjaftueshëm. Strategjia nuk ishte në lidhje me nocionet/shkathtësitë të cilat duhet të zhvillohen.</p> <p>Ndoshta shtrova disa pyetje, por nxënësit nuk u kyçën në të menduarit e hollësishëm të nocionit/shkathtësisë.</p> <p>Nuk u dhash kohë nxënësve që tërësisht t'i shfaqin idetë e tyre. Nuk morra informata të mjaftueshme për dituritë paraprake të tyre.</p>	<p>Planifikova strategji për kyçjen e nxënësve në nocionin / shkathtësinë, por nuk kontrollova njohuritë paraprake.</p> <p>U dhash kohë nxënësve që ta shfaqin kuptueshmërinë momentale të tyre për nocionin/shkathtësinë.</p> <p>Parashtrova disa pyetje lidhur me nocionet / shkathtësitë të cilat mësohen, njohuritë paraprake dhe fitova ide për atë që e dinë.</p>	<p>Planifikova strategji të mirë që kyçë sesionin me pyetje, dizajnuar në mënyrë që t'i kyçë nxënësit në kontrollim të paramenduar të njohurive paraprake për nocionin / shkathtësinë.</p> <p>U dhash kohë nxënësve që t'i përshkruajnë të kuptuarit individual të nocionit / shkathtësisë (në formë të shkruar ose vizatuar – mundet individualisht ose në grup).</p> <p>Nxënësit shfaqën dëshirë për të filluar aktivitet hulumtues si hap i natyrshëm vijues, sepse parashtruan pyetje ose ishin kureshtarë.</p>



segment nga leksioni	kategoritë të cilat vlerësohen		
	Kërkon përmirësim	kuptueshmëri	shëmbëlltjërë
Hulumtimi	<p>U dhashë informata nxënësve, të gjejnë mënyrën e të mësuarit përmes hulumtimit të tyre.</p> <p>Nuk i kyça në hulumtim të vërtetë (duke shfrytëzuar një ose më tepër shkathtësi të procesit).</p> <p>Aktiviteti ishte i udhëhequr kryesisht nga arsimtari, atëherë kur nxënësit do të mundnin më tepër të hulumtonin.</p> <p>Aktiviteti nuk ishte mirë i planifikuar – nxënësit nuk dinin pse e zhvillonin aktivitetin.</p>	<p>Aktiviteti i shfrytëzuar/depajnuar që i kyçë nxënësit në shfrytëzimin e një ose më tepër shkathtësive të procesit për hulumtimin e nocionit/shkathtësisë.</p> <p>Nxënësit e kryen dhe u kënaqëne aktivitetin, por ndoshta nuk kuptuan përse e bënë.</p> <p>Aktiviteti që prezentuar në atë mënyrë që nxënësit nuk parashtruan pyetje të tyre ose nuk treguan kurreshtje më tepër se sa aktiviteti.</p>	<p>Aktiviteti i shfrytëzuar/depajnuar që i kyçë nxënësit në hulumtim të vërtetë duke shfrytëzuar një ose më tepër shkathtësi të procesit.</p> <p>Nxënësve u që prezentuar problemi i cili nxitë ose provokon interesimin e tyre</p> <p>Dukeshte haptas se ncënësit jo vetëm që u kënaqën me aktivitetin, por edhe gjeneruan pyetje të reja dhe demonstruan kurreshtje.</p> <p>Keni ndjenjën se pyetjet e parashtruara nga ky aktivitet do t'ju udhëhiqnin ju dhe nxënësit tuaj në leksion tjetër.</p>
Aplikimi dhe vlerësimi i përparimit	<p>Kërkova nga nxënësit diçka që nuk ishte i lidhur me nocionin / shkathtësinë ose edhe pse ishte i lidhur, nuk kërkova nga ata që ta aplikojnë të kuptuarit e ri për nocionin / shkathtësinë.</p> <p>Strategjia nuk la mundësi që nxënësi ta aplikojë diturinë e re për të kuptuarit e nocionit / shkathtësisë në jetën e përditshme. Strategjia nuk ofroi informata për vlerësimin e të kuptuarit e ri të nocionit / shkathtësisë.</p>	<p>Strategjia që ngërthen nxënësit në shfrytëzimin e nocionit/ shkathtësisë në situatë të re ose në sqarimin e asaj që e kanë mësuar.</p> <p>Nxënësit bënë lidhje të zbehta ose minimale me atë që kanë bërë në pjesët paraprake të leksionit. Nxënësit bënë lidhje minimale ose të dukshme me jetën e tyre të përditshme.</p>	<p>Strategjia që ngërthen nxënësin në aplikimin e njohurisë së tij të re për nocionin / shkathtësinë gjatë zgjidhjes së problemit; përgjigjen në pyetje lidhur me nocionin / shkathtësinë ose sqarojnë për atë se si informata e re është e lidhur me gjërat që i bëjnë në jetën e përditshme.</p> <p>Kjo strategji u ndihmon nxënësve të bëhen të vetëdijshëm për atë se si duhet ndryshuar të kuptuarit e tyre dhe jep përmbajtje për përparimin e nxënësve që mund të shërbejë për vlerësimin e shfaqjes së tyre.</p>



segment nga leksioni	kategoritë të cilat vlerësohen		
	Kërkon përmirësim	kuptueshmëri	shëmbëlltyrë
Përmbledhje për tërë leksionin	<p>Strategjitë janë shfrytëzuar në dy ose më tepër faza dhe nuk e promovuan "sjelljen e të menduarit" që pritej te nxënësit për atë fazë konkrete.</p> <p>Dy ose më tepër faza nuk u përkitnin qëllimeve të parashtruara lidhur me nocionin / shkathtësinë në këtë cikël të të mësuarit.</p>	<p>Strategjitë e shfrytëzuara në të gjitha fazat nxitën "sjelljen e të menduarit" që pritej te nxënësit për atë fazë konkrete</p> <p>Njëra nga fazat nuk u përkitnin qëllimeve të parashtruara lidhur me nocionin / shkathtësinë në këtë cikël të të mësuarit</p>	<p>Strategjitë e shfrytëzuara në të gjitha fazat nxitën "sjelljen e të menduarit" që pritej te nxënësit për atë fazë konkrete</p> <p>Të gjitha fazat u përkitnin qëllimeve të parashtruara lidhur me nocionin / shkathtësinë në këtë cikël të të mësuarit dhe mundësuan rrjedhje të qetë të procesit të mësimit.</p>

PËRPUNO DHE PREZENTO LISTË-KONTROLLI TË PËRMBAJTJEVE MËSIMORE NGA PROGRAMI MËSIMOR NGA GJEOGRAFIA NË TË CILAT MË SË MIRI DO TË APLIKOHEJ CIKLI I TË MËSUARIT

Mendoni dhe shënoni përmbajtje mësimore të mundëshme ku do të aplikohet cikli i mëimit.

Me kolegen/un afër Jush ndani mendimin Tuaj dhe shënoni listën e përbashkët Tuaj të përmbajtjeve mësimore ku do të aplikohet cikli imësimi.

**PËRPUNO DHE PREZENTO ORË MËSIMORE NGA GJEOGRAFIA SIPAS
CIKLIT TË MËSIMIT, DUKE PËRDORUR INTERNETIN SI VEGËL**

Zgjidhni përmbajtje mësimore nga programi mësimor nga gjeografia. Planifiko se si me ndihmë të internetit, së bashku me nxënësit do të arini ta realizoni përmbajtjen mësimore.

Në letër plakati shënoni fazat, si do ta planifikoni përmbajtjen mësimore.

Gjat hulumtimit të Juaj mund ta përdoreni Veb faqen.

Punoni në grupe. Rezultatet e Juaja në lloj të punimit pregaditni për prezentim para kolegëve.

LISTA E VEB FAQEN TE GJEOGRAFISE

http://www.hydrology.vu/hydrology.index_bgc.html
<http://www.nationalgeography.com>
<http://www.astronomy.com>
<http://www.nasa.gov>
<http://www.encyclopedia.mns.com>
<http://www.astronomija.com>
<http://www.weather.com>
<http://www.river.com>
<http://www.atmosfera.com>
<http://www.science.org>
<http://www.volcanologia.com/eruption>
<http://www.maps.com>
<http://www.maps.yahoo.com>
<http://www.sciencenews.com>
<http://www.visibleearth.nasa.gov>
<http://www.filer.case.edu>
<http://www.sciencenewsforkids.org>
<http://www.nativeaccess.com>
<http://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/index.html>
<http://www.classzone.com/books/earthscience/terc/navigation/home.cfm>
<http://geography.usgs.gov/>
<http://www.geographynetwork.com/>
<http://en.wikipedia.org/wiki/Portal:Geography>
<http://www.geography-site.co.uk/>
<http://www.geographyinaction.co.uk/>
<http://www.geography4kids.com/>
<http://www.geography.learnontheinternet.co.uk/>
<http://www.geography.btinternet.co.uk/>
<http://www.space.com/>
<http://www.solarviews.com/eng/homepage.htm>
<http://hubblesite.org/>
<http://stardate.org/>
<http://www.worldmapper.org/>
<http://www.geography.net>

PËRMBAJTJA

HYRJE		5
TEMA 1	MËSIMI CILËSOR	7
	1.1. Karakteristikat e mësimit cilësor	9
	1.2. Punëtori 1 dhe 2	10
	1.3. Karakteristikat për orë mësimore të suksesshme	11
TEMA 2	NOCIONET DHE MËSIMDHËNIA	13
	2.1. Aktiviteti mental gjatë formimit të nocioneve	15
	2.2. Nocionet dhe mësimdhënia e shkencave të natyrës	17
	2.3. Pesë temat të gjeografisë	20
	2.4. Punëtorja 3	24
TEMA 3	CIKLI I TË MËSUARIT	27
	3.1. Punëtorja 4	29
	3.2. Cikli i të mësuarit	30
	3.3. Katër fazat e ciklit të të mësuarit	32
	3.4. Lidhshmëria e ciklit të të mësuarit dhe të formuarit e nocioneve	36
	3.5. Cikli i të mësuarit dhe teoritë tjera të të mësuarit	37
	3.6. Të mësuarit kooperativ, Shoqëria Shkencoro-teknike (SHSHT) dhe cikli i të mësuarit	40
	3.7. Cikli i të mësuarit dhe mësimi aktiv	42
	3.8. Shkathësitë e të menduarit dhe aktivitete të nxënësit në ciklin e të mësuarit	44
	3.9. Punëtorja 5	46
TEMA 4	PLANIFIKIMI, DIZAJNIMI DHE VLERËSIMI I ORËS MËSIMORE	53
	4.1. Propozim i modelit për përgatitje ditore për orë	56
	4.2. Propozimet për planifikim hap-pas-hapi	57
	4.3. Shembuj të ecurive dhe forma të mësimdhënies për secilën fazë	58
	4.4. Punëtorja 6	60
	4.5. Vlerësimi i planifikimit të leksioneve tuaja	61
	4.6. Vlerësimi i realizimit të leksioneve tuaja	62
	4.7. Punëtorja 7	65
	4.8. Punëtorja 8	66
	4.9. Punëtorja 9	67
	Lista e veb faqen te gjeografise	68